



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

PS.nr.35/2022

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË**, Kryetari i Trupit Gjykses, Gjyqtari Valon Kurtaj, me Anëtarët e Trupit Gjykses, Gjyqtaren Valbona Musliu Selimaj e Gjyqtarin Arben Hoti dhe pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Fatlum Gashi e Bashkëpunëtores Profesionale Ardita Azemi, në çështjen penale të të akuzuarve B. I., Sh. I., M. I., U. Q. dhe A. Z., të akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK e lidhur me veprën penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 1 të KPRK dhe i akuzuari B. I., i akuzuar edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, të akuzuar sipas Aktakuzës PPS.nr.14/2022 të datës 30.09.2022 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas mbetjes së një sërë shqyrtimesh gjyqësore publike në prezencën e të akuzuarve, mbrojtësve të të akuzuarve dhe Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me datë 28.07.2023, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

- B.I.**, i lindur me datë ... në fshatin ... të Komunës së Gj., nga i ati M., ëma Rr. e vajzërisë Sh., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së Gj., posedon dokument identifikimi me numër personal ..., i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të përfunduar shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;
- SH.I.**, i lindur me datë ... në fshatin ... të Komunës së Gj., nga i ati M., ëma Rr. e vajzërisë Sh., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së Gj., i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion ndërtimtar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;
- M.I.** i lindur me datë ... në A., nga i ati B., ëma S. e vajzërisë A., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së Gj., posedon kartë identiteti me numër personal ..., i martuar, baba i 1 fëmije, ka të përfunduara shkollimin e mesëm, me profesion kamerier, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

4. **U.Q.** i lindur me datë ... në Gj., nga i ati Gj., e ëma L. e vajzërisë P., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së Gj., posedon kartë identiteti me numër personal ..., i martuar, baba i 5 fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin mesëm, me profesion kuzhinier, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;
5. **A.Z.** i lindur me datë ... në fshatin ... të Komunës së L., nga i anit B., ëma Z. e vajzërisë K., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së L., posedon kartë identiteti me numër personal ..., i pamartuar, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## **I.**

### **Të akuzuarit B.I. e Sh.I:**

#### **JANË FAJTOR**

Sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021 në fshatin ... të Komunës së Gj., respektivisht në shtëpitë e tyre familjare, në bashkëkryerje e vazhdimësi të akuzuarit B. I., Sh. I. dhe i akuzuari në arrati F. M., pa autorizim kanë prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerr në qarkullim-për shitje substancë narkotike dhe atë:

- I akuzuari B. I., përmes një shtetasi gjerman me emrin e njohur A. B., fillimisht siguron farat për mbjelljen e narkotikut të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”, ku së bashku me vëllain e tij Sh. I. e të akuzuarin në arrati F. M., mbjellin-kultivojnë narkotikun në parcelën afër shtëpive të tyre (të të akuzuarve B. e Sh. I.) në fshatin ... dhe në një parcelë tjetër të paidentifikuar, pastaj e terin, përpunojnë substancën narkotike në objektet përcjellëse të shtëpive të tyre, ku e kanë nxjerr në qarkullim-shitje këtë substancë narkotike brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- Të akuzuarit, substancën narkotike të kultivuar e kanë nxjerrë në qarkullim-shitje dhe atë përmes të akuzuarve: F. M. (i akuzuar në arrati); M. I. U. Q. e A. Z. Të akuzuar të cilët pa- autorizim janë furnizuar me lëndë narkotike tek të akuzuarit B. I. e Sh. I., e më pas të njëjtin narkotik pa-autorizim e kanë poseduar më qëllim të shitjes së tij;
- Me datë 24.12.2021, me rastin e kontrollit të shtëpive e objekteve përcjellëse të të akuzuarve, ku tek B. I. në paketime të ndryshme janë gjetur substancë narkotike në peshë neto prej 8,714.00 gram, 1 (një) peshore me mbishkrim “Foraco” me mbetje të pluhurit të bardhë, 17 (shtatëmbëdhjetë) bimë të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”, 1 (një) peshore digjitale me mbishkrim “First”, 130 (njëqind e tridhjetë) fara të “Kanabis Sativa-Marihuanë”, 1 (një) palë gërshërë për krasitjen e bimëve narkotike, pajisje për ndriçim artificial të përdorura në kultivimin e bimës narkotike, ndërsa tek Sh. I. janë gjetur substancë narkotike në peshë prej 1,083.9 gram, 5 (pesë) palë gërshërë për krasitjen e bimëve narkotike, 1 (një) peshore digjitale për matje, 10 (dhjetë) fara të “Kanabis Sativa-Marihuanë” e të cilat janë sekuestruar nga policia me rastin e kontrollit;

- Pas ekzaminimit nga Agjencia Kosovës për Forenzikë, konstatohet se tek substanca bimore në dëshmitë e ekzaminuara ka rezultuar prezencë e “Kanabis Sativa-Marihuanë” që përmban “Tetrahidrokanabinol (HTC)”, ndërsa ekzaminimi i farave bimore dhe mbetjeve të substancës me ngjyrë të gjelbër ka treguar prezencë të “Kanabis Sativa-Marihuanë”, ku mbetjet e pluhurit të gjetura në peshoren “Farco” ka treguar se është prezencë e narkotikut të llojit “Kokainë”.

**Me këto veprime të akuzuarit kanë kryer veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPRK.**

## **II.**

**I akuzuari B.I.:**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021, në vazhdimësi në fshatin ... të Komunës së Gj., respektivisht në objektin përcjellës të shtëpisë së tij (garazh) në dollap metali, i akuzuari B.I., ka mbajtur në pronësi, kontroll e posedim të paautorizuara 10 (dhjetë) fishek të kalibrit 7.62X54mm me mbishkrimin 19/67 dhe 1 (një) fishek të kalibrit 7.62X39mm me mbishkrimin 88, të cilat janë gjetur me rastin e kontrollit të shtëpisë së të akuzuarit nga Policia e Kosovës, e po ashtu në këtë kontroll janë sekuestruar.

**Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.**

## **III.**

**I akuzuari M.I.:**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021, në vazhdimësi në Gj., respektivisht në lokalin e tij “Secret Shisha Bar”, pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje, shpërndarje, e ofrimi për shitje substancën narkotike të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” e “Kokainë”, duke i ndarë sasi të “Kanabis Sativa-Marihuanë” dhe “Kokainës” në sasi më të vogla dhe atë në doza me shuma të caktuara, duke përfshirë në sasi 5 (pesë) Euro, 10 (dhjetë) Euro dhe 50 (pesëdhjetë) Euro, narkotik “Kanabis Sativa-Marihuanë” e cila pa autorizim është prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerrë në qarkullim-shitje nga të akuzuarit B.I., Sh.I. dhe i akuzuari në arrati F.M.

dhe narkotik “Kokainë” ku mbetjet e saj janë gjetur gjatë kontrollit tek i akuzuari B.I., më specifikisht përshkruar sikurse nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.**

**IV.**

**I akuzuari U.Q:**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021, në vazhdimësi në Gj., respektivisht në fshatin ... të Komunës së Gj., pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje, shpërndarje, e ofrimi për shitje substancën narkotike të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” e “Kokainë” ku:

- Narkotikun e llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”, pa autorizim i prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerrë në qarkullim-shitje nga të akuzuarit B.I., Sh.I. e i akuzuari në arrati F.M., ku ia kanë ofruar për shitje (ia kanë shitur) narkotikun të akuzuarit A.Z. i cili e ka blerë narkotikun nga këta të akuzuar në fshatin ... e më pastaj është drejtuar për P., ku me rastin e shitjes së narkotikut i akuzuari U.Q., ka marrë pjesë në shitje të narkotikut së bashku me të akuzuarit B.I., Sh.I. e F.M., të cilët më parë edhe e kishin kultivuar këtë lëndë narkotike, ndërsa U.Q. ka marrë pjesë në shitjen e tij;
- Narkotikun e llojit “Kokainë”, ku me rastin e kontrollit të shtëpive e objekteve përcjellëse të të akuzuarve B.I. e Sh.I., në shtëpinë e B.I., janë gjetur mbetjet “Kokainës”, ku i akuzuari U.Q., e ka siguruar-blerë paraprakisht nga i akuzuari B.I. dhe e ka vënë në posedim të tij me qëllim të shpërndarjes, vënies në posedim-dispozicion L. N., e të cilët narkotikun e siguruar-blerë nga B.I., ku në rastet e caktuara e kanë konsumuar bashkë U.Q. dhe L. N.

**Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.**

**V.**

**I akuzuari A.Z.:**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021, në vazhdimësi në Gj., respektivisht në fshatin ... të Komunës së Gj., ka takuar-kontaktuar të akuzuarin B.I., me qëllim të sigurimit të

narkotikut të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” dhe pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje, shpërndarje, e ofrimi për shitje substancën narkotike të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” ku:

Për sigurimin e narkotikut “Kanabis Sativa-Marihuanë”, pa autorizim të prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerrë në qarkullim-shitje nga të akuzuarit B.I., Sh.I. e i akuzuari në arrati F.M., i akuzuari A.Z. disa herë ka takuar-kontaktuar të akuzuarin B.I., për sigurimin e narkotikut, ku me datë 9.12.2021, paraprakisht B.I. i ka thënë “*a ke gjetur ndonjë myshteri të ri, t’i e ke çmimin e prerë veç më thuaj*” e ku i akuzuari A. i përgjigjet “*po vij po i marrë qata dy klysh*”, ka shkuar me automjetin e tij në fshatin ... të Komunës së Gj. (në shtëpinë e të akuzuarit B.), ka siguruar narkotik të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” me qëllim shitjeje, shpërndarje, ofrimi për shitje, ku me rastin e sigurimit të narkotikut nga i akuzuari B., prezent kanë qenë edhe të akuzuarit U.Q., Sh.I. e F.M..

**Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 20, 21, 22, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 76, 77, 79, 267 paragrafi 1, 268 paragrafi 1 dhe 366 paragrafi 1 të KPRK, të akuzuarve iu shqipton:

## **DËNIMIN ME BURGIM DHE DËNIMIN ME GJOBË**

### **1. B.I.:**

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **4 vite e 6 muaj burgim** i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 24.12.2021 e deri më datë 28.07.2023;

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **7,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Për veprën penale si nën **II.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **1,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata në harmoni me nenin **76 të KPRK**, të akuzuarit i vërteton-shqipton dënimin unik me gjobë:

Për veprat penale si nën **I.** dhe **II.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi unik me gjobë në lartësi prej **8,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20 Euro**, për një ditë burgimi, por duke mos kaluar afatin maksimal prej **3** vjet burgim.

## **2. Sh.I:**

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **4 vite burgim** i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 24.12.2021 e deri më datë 28.07.2023;

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **5,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20 Euro**, për një ditë burgimi, por duke mos kaluar afatin maksimal prej **3** vjet burgim.

## **3. M.I:**

Për veprën penale si nën **III.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 vite burgim** i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 24.01.2021 e deri më datë 28.07.2023;

Për veprën penale si nën **III.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **5,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20 Euro**, për një ditë burgimi, por duke mos kaluar afatin maksimal prej **3** vjet burgim.

## **4. U.Q:**

Për veprën penale si nën **IV.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 vite burgim** i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 24.12.2021 e deri më datë 28.07.2023;

Për veprën penale si nën **IV.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **5,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20 Euro**, për një ditë burgimi, por duke mos kaluar afatin maksimal prej **3 vjet** burgim.

#### **5. A.Z.:**

Për veprën penale si nën **V.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 vite e 6 muaj** burgim i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Për veprën penale si nën **V.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej **5,000.00 Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20 Euro**, për një ditë burgimi, por duke mos kaluar afatin maksimal prej **3 vjet** burgim.

Të akuzuarve **B.I., Sh.I., U.Q.**, iu ndërpritet masa e paraburgimit që nga dita e sotme e shpalljes së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit **M.I.** i ndërpritet masa e arrestit shtëpiak që nga dita e sotme e shpalljes së këtij aktgjykimi.

*Në harmoni me nenin 269, 270 e 271 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës:*

**KONFISKOHEN SENDET-PASURIA**, sendet-pasuria e përdorur apo e destinuar për kryerjen e veprës penale, sendet-pasuria e rezultuar-gjeneruar nga vepra penale e sekuestruar sipas Urdhrit nën numrin PP.nr.174/2021 i datës 19.01.2022 i Gjykatës Tmemelore-Departamenti Krimeve Rënda në Mitrovicë dhe atë:

#### **Pasuria-sendet e përdorura e të gjeneruara nga/në vepër penale :**

- Veturë “Mercedes” me targa ..., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari Sh.I., e evidentuar me numrin V#1;
- Veturë “Mercedes” me targa ..., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I., e evidentuar me numrin V#2;

- Vetura “Volkswagen” me targa ...., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I. e evidentuar me numrin V#3;
- Veturë “Smart” me targa ..., veturë në pronësi (e blerë) nga i akuzuari B.I. dhe e përdorur nga familjarët e tij, e evidentuar me numrin V#4;
- Telefon “Nokia” me IMEI ..., telefon në pronësi të akuzuarit B.I. e evidentuar me numrin T#1;
- Telefon “Iphone” me IMEI ..., në pronësi të të akuzuarit B.I. e evidentuar me numrin T#2;
- Telefon “Iphone” me ngjyrë hiri i modelit A1688(S6) në pronësi të të akuzuarit Sh.I., e evidentuar me numrin F#3;
- Telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë i modelit S9+ në pronësi të të akuzuarit M.I., e evidentuar me numrin F#2;
- Telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë, e evidentuar me numrin F#1.

**Narkotiku, municioni i armës dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:**

Nga i akuzuari B.I., konfiskohet sasia e narkotiku, municioni i armës dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:

- Sasia e narkotiku e evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse më lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#7, D#8, D#10, D#10.1, D#13, D#14, D#A.1, D#A.2, D#A.3, D#A.4, D#17, D#18, D#19, D#20, D#20.1, D#22, D#23, D#24, D#25, B#1, B#2, B#3, B#4;
- Mjetet për kryerjen e veprës penale të evidentuara në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#9, D#11, D#12, D#14.1, D#15, D#20.2, D#21;
- Municioni i armës i evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#16.

Nga i akuzuari Sh.I., konfiskohet sasia e narkotiku dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:



- Sasia e narkotiku e evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij aktgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#1, D#2, D#3 dhe D#5;
- Mjetet për kryerjen e veprës penale të evidentuara në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij aktgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#4 dhe D#6.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, urdhërohet shkatërrimi i substancës narkotike dhe municionit të konfiskuar, e të përdorura në kryerjen e veprës-veprave penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, obligohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar të merr nën administrimin e saj pasurinë e konfiskuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtën ta administroj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Obligohen të akuzuarit-çdo njëri prej tyre (veç e veç) të paguaj shumën prej **200** (njëqind) **Euro** në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe shumën prej **100** (njëqind) **Euro** në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **Historiku procedural i çështjes:**

Me datë 30 shtator 2022, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur Aktin akuzues PPS.nr.14/2022, kundër të akuzuarve B.I., Sh.I., M.I., U.Q. dhe A.Z., të akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK e lidhur me veprën penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 1 të KPRK dhe i akuzuari B.I., i akuzuar edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK.

Me datë 31.10.2022, Gjykata Themelore-Departamenti Speciale në Prishtinë, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, ku të akuzuarit kanë kundërshtuar aktin akuzues dhe sa i përket fajësisë, kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen. Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, janë njoftuar se brenda afatit të caktuar ligjor, kanë mundësinë për të parashtruar kërkesat për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave.

Me rastin e parashtrimit nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, të kërkesave për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave, gjykata të njëjtat i ka shqyrtuar e më pas i ka hedhur si të pabazuara.

Të akuzuarit-mbrojtësit e tyre, në afat ligjor kanë ushtruar ankesë ndaj vendimit me të cilin janë hedhur kërkesat për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave. Gjykata Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, në raport me ankesat e ushtruara, ka refuzuar të njëjtat dhe vendimin e shkallës së parë e ka lënë në fuqi, respektivisht e ka lënë në fuqi aktin akuzues.

Gjykata, në drejtim të procedimit të këtij akti akuzues, ka mbajtur një sërë shqyrtimesh gjyqësore, ku në fund e ka shpallur këtë aktgjykim sikurse në hyrje të tij.

### **Fjala përfundimtare e palëve:**

Palët në këtë çështje penale kanë parashtruar-prezantuar fjalën përfundimtare të tyre, ku gjykata në këtë pjesë do të shtjelloj-potencoj pretendimet e theksuara në fjalën përfundimtare.

**Prokuroria Speciale Republikës Kosovës**, respektivisht Prokurori Special në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar:

- Elementet e veprave penale me të cilat janë ngarkuar të akuzuarit sipas aktakuzës duke potencuar se “*Grupi i organizuar kriminal*”, do të thotë grup i përbërë prej së paku tre e më shumë persona i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të kryerjes së një apo më shumë të veprave penale të rënda ose vepra penale të përcaktuara në bazë të Konventës së Kombeve të Bashkuara, e me qëllim të përfitimit të dobisë financiare apo materiale të kundërligjshme në mënyrë direkt apo indirekt dhe se “*Grup i strukturuar*”, do të thotë grup i cili nuk është bashkuar rastësisht për të kryer vepra penale aty për aty dhe nuk duhet të kenë të përcaktuar formalisht rolet e anëtarëve të vet, kohëzgjatja e anëtarësimit ose strukturën e përpunuar, e që veprimi i kryerjes është marrja pjesë me vetëdije në veprimtarinë kriminale të grupit kriminal;
- Sa i përket provave materiale dhe personale prokuroria ka theksuar se të gjitha provat të administruara në shqyrtim gjyqësor janë prova të pranueshme të siguruara në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe që i është dhënë e drejta e paraqitjes së mbrojtjes të akuzuarve, ku disa nga ta janë përgjigjur vetëm në pyetje të mbrojtësve, disa nga ta gjatë mbrojtjes së tyre kanë mohuar kryerjen e veprave penale që iu vihen në barrë.
- Prokurori ka shtuar se sa i përket masave të fshehta për përcjelljen e vendndodhjes-GPS për automjetin e markës “BMW” i cili ishte në pronësi dhe shfrytëzim të pandehurit B.I., e që ky i fundit kishte pranuar se e ka pasur në pronësi atë veturë dhe se të njëjtën e kishte shitur tri javë para se të arrestohej, ku gjatë zbatimit të kësaj mase i pandehuri B.I., është dëgjuar duke biseduar me të pandehurit e tjerë Sh.I., M.I., U.Q., F.M. dhe A.Z. dhe persona tjerë të cilët nuk janë identifikuar e që në raste të ndryshme duke lëvizur me veturën në fjalë ku ishin dëgjuar biseda për narkotik rreth tharjes-kultivimit dhe shitjes së bimëve narkotike të llojit “Marihuanë”. Më tej ka theksuar se nga bisedat e përgjuara është vërtetuar se B.i dhe F., kanë mbjellë e po kultivojnë narkotikë duke i përgatitur për t’i shitur të cilat edhe i kanë shitur.

- Gjithashtu në bisedën e dëgjuar të datës 25.10.2021 është vërtetuar se Sh. ka bashkëvepruar me B. duke bërë plane se si do t'i mbjellin narkotikët në vitin e ardhshëm. Nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara në mes të pandehurve dhe personave të tjerë që nuk janë identifikuar ka rezultuar se të njëjtit kanë biseduar mes veti por se të pandehurit kanë qenë shumë të kujdesshëm duke folur me kode dhe zhargone të cilët kishin lënë kohën për takime ku më pas edhe ishin takuar për të arritur marrëveshje për shitjen e “Marihuanës”.
- Gjithashtu edhe nga transkripti në mes të Sh.I. dhe M.I. në veturën në të cilën ishte vendosur GPS është vërtetuar bashkëveprimi i tyre në kultivimin e narkotikeve dhe përgatitjen për treg. Se veprimet e të pandehurit M.I. vërtetohen edhe nga provat që janë siguruar pas ekzaminimit të telefonit “Samsung Galaxy S9” nga dosja e “Facebook Messenger” e datës 26.05.2021 me përmbajtje *“a ki naj sen veresi me ardhe me marr se diqa me dhez njo”* nga dosja e “Viber” e që këto dhe shumë dëshmi të tjera të bashkangjitura raportit të ekzaminimit të telefonit vërtetojnë veprimet e këtij të akuzuari në bashkëveprim me të akuzuarin B. dhe Sh., ku nga videot dhe fotot e nxjerra nga telefoni shihen lloje të ndryshme të substancave narkotike “Marihuanë”.
- Prokurori më tej ka theksuar se i pandehuri U.Q. ka pranuar fajësinë vetëm sa i përket vet konsumimit të narkotikeve pasi që i njëjti konsumon narkotik nga viti 1997 duke mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën ngarkohet gjithashtu duke mohuar se ka bashkëvepruar me të pandehurit e tjerë ku disa nga ta i ka njohur. Nga dëshmia e dëshmitarit L. N., vërtetohet se U.Q. ka qenë i angazhuar për gjetjen e blerësve për narkotik për të pandehurin B.I., duke kontribuar në këtë mënyrë për veprimtarin e grupit kriminal.
- Sa i përket të pandehurit A.Z., prokuroria ka theksuar se i njëjti edhe pse është mbrojtur në heshtje veprimet e tij vërtetojnë shumë qartë se nga transkriptet e bisedave të siguruara përmes masave të fshehta ku në bisedën e datës 12.10.2021, dëshmohet bashkëveprimi i tij me B. e N. edhe më parë me dijeninë e tij se B. edhe vitin paraprak kishte kultivuar narkotik. Veprimet e të pandehurit A.Z. vërtetohen edhe me masat e fshehta të vëzhgimit me të cilat masa është vërtetuar se ky i pandehur ka pasur një veturë “Golf V” e që me veturën e përmendur kishte qenë në shtëpinë e B.it, ku atë ditë ishte furnizuar me narkotik nga B. i cili nuk ishte zënë për shkak se ka shfrytëzuar rrugët dytësore duke u larguar nga fshati ... në drejtim të P.
- Nga transkripti i datës 31.10.2021 i zhvilluar në mes të pandehurit B. e F.M. është vërtetuar se i pandehuri B.I., përveç që ka kultivuar vet narkotik i njëjti edhe ka blerë narkotik me qëllim të shitjes. Gjithashtu nga transkripti i datës 01.11.2021 e cila bisedë ishte bërë në gjuhën serbe ka dëshmuar se i pandehuri B. ka bërë shitje të narkotikeve edhe jashtë Kosovës, si në Austri e në Serbi. Prokurori ka analizuar e elaboruar edhe deklaratën e dëshmitarit G. G. i cili ka pranuar se ka blerë substancë narkotike “Marihuanë” nga B., dy apo tre herë, njëherë kishte paguar 50 Euro dhe dy apo tre here

nga 10 Euro, ku që të gjitha herët B. ia kishte dërguar në lokal narkotikët, pra me të cilën deklaratë ka hedhur poshtë deklaratën e mbrojtjes së të pandehurit, ku B. i cili ka deklaruar se asnjëherë nuk ka shitur narkotikë.

- Raporti i ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, rezulton se konstatimi dhe mendimi përfundimtar ku sipas karakteristikave morfologjike e përbërjes kimike, dëshmitë e cekura në atë raport përmbajnë kanabis (mariuhanë) me peshë të përgjithshme prej 8,321.22 gram, por sa i përket mos përputhjes së peshës me atë të aktit akuzues dhe raportit në fjalë, eksperti i forenzikës i dëgjuar në shqyrtim gjyqësor është pajtuar se narkotiku mund të humb peshë gjatë tharjes prej vjeljes dhe deri në kohën e dërguar për ekzaminim.
- Prokuroria më tej në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se me veprimet e të pandehurve B.I., Sh.I., U.Q., M.I., A.Z. dhe F.M., ky i fundit gjendet në arrati, manifestohen elementet e veprave penale për të cilat akuzohen. Pra duke marr parasysh gjitha provat e administruara duke i vlerësuar ato në lidhmëni logjike dhe faktike me njëra tjetrën, prokuroria konsideron se vërtetohet përtej dyshimit se me veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet e veprave penale që ju vihen në barrë sipas aktakuzës të pandehurve e që në këtë rast është vërtetuar se këtu ka të bëjë me një grup të organizuar me më shumë se tre persona, ku në përbërje të tij ka pasur pjesëtar-shtetas të Kosovës e të Shqipërisë, prej të cilëve dyshohet se ishte blerë narkotiku, përveç atyre që e kishin kultivuar vetë por nga Serbia.
- Me provat e siguruar nga gjitha masat e fshehta vërtetohet se i pandehuri B.I., është organizator i grupit edhe pse i njëjti në mbrojtjen e tij është mundur të mbrohet duke thënë se “Mariuhanën” e ka mbjellë për ta përdorur si shërues për problemet e lukthit si i kanë thënë disa shokë nga Shqipëria, e që me blerje, prodhim e kultivim, ishin marr B.I., F.M. dhe Sh.I., por edhe të pandehurit U.Q. e A.Z., aktivisht kishin qenë pjesë e veprimtarisë kriminale të grupit duke kontribuar në realizimin e veprimtarisë së grupit, ku këta dy të fundit kishin gjetur blerës kjo vërtetohet me provat e siguruar nga masat e fshehta gjatë hetimit.
- Prokuroria krejt në fund të fjalës përfundimtare ka theksuar se të pandehurit janë fajtor pasi veprat penale i kanë kryer me dashje dhe dijeni, se ata janë penalisht përgjegjës meqenëse nuk ekziston asnjë rrethanë e cila e përjashton përgjegjësinë e tyre penale duke propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit. Me këtë rast si rrethanë rënduese të merret parasysh shkalla e lartë e pjesëmarrjes në kryerjen e veprave penale, shkalla e lartë e dashjes së tyre, veprën e kryer në paramendim, pasojat e rënda që shkaktojnë veprat penale të kësaj natyre sidomos rininë, e të cilat vepra janë me rrezikshmëri të lartë e mohimin e kryerjes së veprave penale nga të pandehurit përkundër provave bindëse si dhe mungesës së pendimit, ka propozuar që të konfiskohen të gjitha asetet-sendet e propozuara si në aktin akuzues duke përfshirë edhe automjetin “Smart”.

I akuzuari **B.I.**, respektivisht mbrojtësit e tij Avokat F. K. e Avokat G. K., në fjalën përfundimtare kanë theksuar:

- Ka qenë obligim i prokurorisë në shqyrtim gjyqësor ta bind gjykatën se me veprimet e të mbrojturit të tyre manifestohen elementet e veprave penale si në aktakuzë, por që prokuroria nuk ka theksuar asgjë më shumë se sa është gjetur një sasi e narkotikut tek B.I. e që sasinë në fjalë i mbrojturi i tij, asnjëherë nuk e ka mohuar për të cilën edhe ka shprehur pendesë të madhe. Mbrojtja ka theksuar se prokuroria është dashur të tërhiqet për pikën II. të aktakuzës e meqenëse kjo nuk ka ndodhur nga ana e prokurorisë atëherë bie barrë e mbrojtësve që të arsyetojnë se me veprimet e të mbrojturit të tyre nuk korrespondojnë elementet e veprës penale krim i organizuar lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK.
- Më tej është shtuar nga mbrojtësit se është obligim i prokurorisë që aktakuzën ta mbështet në çfarëdo prove personale dhe materiale. Ta arsyetoj mirë edhe të drejtën materiale si në përshkrim të gjendjes faktike ashtu edhe në arsyetim e që në këtë rast është dashur ta arsyetoj në mënyrë të detajuar rolin e secilit të akuzuar në organizatën e pretenduar, e që organi akuzës kur thirret në krim të organizuar duhet t'i arsyetoj mirë karakteristikat e tij dhe të dihet se nga kush po dirigjohej, apo komandohet e që nuk është ditur as dita apo momenti. Mbrojtja sa i përket përgjimeve ka theksuar se B. me M., janë takuar njëherë ndërsa kanë komunikuar nëntë here nëpërmes telefonit për periudhën 31.10.2021 deri 10.12.2021, pa pasur në konsideratë faktin se të njëjtit kanë relacion baba-djalë. Gjithashtu i mbrojturi i tyre ka komunikuar me të pandehurin Sh. përmes telefonit tetë herë për periudhën 01.11.2021 deri 02.12.2021, pa pasur në konsideratë faktin se të njëjtit janë vëllezër mes vete. Se me të akuzuarin F. i mbrojturi i tyre nuk ka komunikuar asnjëherë përmes telefonit, ndërsa me U. ishin takuar mes vete dy herë me datë 01.11.2021 deri më 14.11.2021, ndërsa përmes telefonit me këtë të fundit kishte komunikuar tetëmbëdhjetë here gjithashtu edhe kjo pa marrë parasysh faktin se të njëjtit ishin miq të vjetër.
- Me të akuzuarit M. dhe Sh., i mbrojturi i tyre është në relacion xhaxha-nip e që me të njëjtit kishte komunikuar përmes telefonit dy herë nga 25.10.2021 deri më 16.12.2021, duke u nisur nga gjitha këto mbrojtja ka potencuar se nëse prokuroria pretendon se këto janë vetëm kontakte inkriminuese e jo që gjitha kontaktet që kishin pasur, atëherë shihet qartë se janë të pamjaftueshme për të vërtetuar se këta pesë apo më shumë persona kanë krijuar një "grup të organizuar". Mbrojtësit më tej kanë shtuar se ligjvënësi ka përcaktuar 4 situata se kur mund të plotësohen elementet e veprës penale nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me par 1 të KPRK, si: prodhimi, transporti, shpërndarja dhe shitja, e që dihet se përshkrimi faktik i akuzës e mbulon kualifikimin juridik, pra nuk mund të ketë kualifikim juridik pa përshkrim faktik, këtë mbrojtja e ka potencuar duke shtuar se prokuroria ka krijuar një fakt juridik, dy gjendje faktike nga një ngjarje jetësore.

- Sa i përket veprës penale nga neni 267 i KPRK, kjo veprë sipas mbrojtësve nuk mund të ekzistoj pa elementin bazë, element ky që është blerja e narkotikut e që nga provat e administruara në gjykatë prokuroria nuk ka arritur të arsyetoj se i mbrojturi i tyre B.I., ka blerë narkotik me qëllim të shitjes. Andaj mbrojtja beson se gjykata do të vendos drejt e ligjshëm dhe të mbrojturin e tyre ta gjej fajtor për veprën penale të prodhimit dhe përpunimit të narkotikeve. Mbrojtja më tej i ka propozuar gjykatës që automjetet e sekuestruara të lirohen me arsyetimin se prokuroria në asnjë rresht nuk ka thënë se ato mjete janë burim i veprës penale, e që nuk janë burim i veprës penale është vërtetuar edhe nga administrimi i provave në këtë çështje penale dhe se ato automjete ishin blerë shumë kohë para se të filloj hetimi.
- Mbrojtja ka potencuar faktin se i mbrojturi i tyre ka pranuar veprën penale për të cilën po gjykohet, se pranimi ka qenë në mënyrë të sinqertë, pendimi nga ana e të mbrojturit të tyre e që pendimi është virtyt i një njeriu dhe nuk mund të pendohet çdo kush. Krejt në fund mbrojtja ka shtuar se pranimi, pendimi si dhe premtimi i të mbrojturit të tyre dhe vetë koha e kaluar në paraburgim kanë ndikuar shumë tek i mbrojturi i tyre B.I., që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla. Mbrojtësi Avokat F. K., përveç fjalës përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar në shqyrtimin e fundit gjyqësor, ka kërkuar nga gjykata që të merr parasysh pendimin e thellë të të mbrojturit të tij, gjendjen shëndetësore të rënduar, e kaluara e tij në shtetin e Kosovës, ku për moshën që e ka mbi 50 vite, është historikisht i pastër.

I akuzuari **B.I.** në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësve të tij, duke shtuar se është penduar dhe më kurrë nuk do të përsërisë veprën penale, duke kërkuar nga gjykata që t'i jepet një dënim sa më i lehtë, duke kërkuar falje për veprën e kryer, shpreh pendesën e tij e premtimin se më nuk do të përsërisë vepra penale, duke e njoftuar gjykatën se në qendrën e paraburgimit ka qenë i angazhuar me punë dhe i vlerësuar me nota maksimale, duke kryer punë vullnetare dhe se nuk ka pasur asnjë vërejtje për sjelljet e tij në burg.

I akuzuari **A.Z.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat A. H. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Prokuroria në asnjë mënyrë nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i mbrojturi i tij ta ketë kryer veprën penale për të cilat akuzohet, për faktin se organi akuzës nuk ka sjellë prova materiale apo personale për të vërtetuar përshkrimin faktit si në aktin akuzues. Gjithashtu nuk është dëshmuar as vërtetuar se i mbrojturi i tij të ketë qenë pjesë e grupit për të cilin pretendon prokuroria e aq më pak t'i ketë njohur të akuzuarit e tjerë përveç B.I., duke shtuar faktin se nëse do të ekzistonte një grup i tillë siç pretendon prokuroria, asnjëherë nuk është cekur se kush ka qenë prijës i atij grupi. Mbrojtja më tej ka shtuar se të mbrojturin e tij as nuk e kanë njohur, as nuk e kanë përmendur në asnjë kontekst dëshmitarët G. G. dhe L. N. Sa i përket provës e listuar numër 2 në aktakuzë, gjegjësisht raporti i 12.10.2021, e cila është provë e një bisede, për mbrojtjen është provë e pa pranueshme ngase është siguruar në kundërshtim me nenin 92 paragrafi 2 nën par.1.1 të ish KPPRK, sepse i mbrojturi i tij nuk ka qenë subjekt i urdhërësës të lëshuar nga gjykata, e që biseda e lartpërmendur e siguruar përmes përgjimeve si informatë e cila ka

mundur të shfrytëzohet nuk ka rezultuar me asnjë provë tjetër përkatësisht të dëshmohet se ka pas në posedim apo të ketë blere e shitur e aq më pak të shpërndajë narkotik i mbrojturi i tij.

- Mbrojtja ka potencuar se në raport me të mbrojturin e tij nuk ekziston asnjë provë tjetër, përveç transkriptit të theksuar si më lartë duke konsideruar se në këtë situatë ekziston vetëm një provë e pa-konfirmuar, e pa-mbështetur, gjithashtu e pa-vërtetuar, e që ndaj të mbrojturit të tij gjykata nuk mund ta përcaktoj fajësinë për të njëjtin, vetëm në bazë të një prove ashtu siç parashihet edhe me nenin 262 të ish KPPRK, apo me nenin 257 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës që është aktualisht në fuqi. Më tej mbrojtja në fjalën përfundimtare ka theksuar se të mbrojturit të tij nuk i është sekuestruar asgjë e kundërligjshme aq më pak narkotik.
- Mbrojtja ka shtuar se është shumë i rëndësishëm fakti që dëshmon se i mbrojturi i tij nuk ka qenë pjesë e grupit, për faktin se i njëjti nuk është arrestuar me datë 24.12.2021 kur janë arrestuar të akuzuarit e tjerë, por se i njëjti është thirrur me datë 07.06.2022, për tu dëgjuar në cilësi të dëshmitarit sikurse edhe dëshmitarët G. dhe L., e që për dallim nga këta të fundit i mbrojturi i tij meqenëse nuk ka qenë dëshmitar interesat dhe i papërdorshëm nga organi akuzës të njëjtit i është ngritur kallëzim penal e më pastaj aktakuzë. Mbrojtësi krejt në fund ka kërkuar nga gjykata që të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza meqenëse nuk ka prova materiale e as personale ndaj të njëjtit dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale bazë, njashtu nuk është vërtetuar se i njëjti ka qenë pjesë e grupit kriminal.

I akuzuari **A.Z.** në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke theksuar se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër nga ajo që ka deklaruar mbrojtësi i tij.

I akuzuari **U.Q.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat N. D. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Sa i përket veprës penale bazë nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK, nëse i referohemi tekstit ligjor të kësaj dispozite dhe duke e krahasuar me provat që ka ofruar prokuroria sipas mbrojtjes rezulton se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk ekzistojnë elementet e veprës penale, meqenëse i mbrojturi i tij nuk ka shpërndarë, nuk ka shitur, nuk e ka kryer asnjë veprim inkriminues nga dispozita e lartpërmendura, pasi që me asnjë provë formale apo materiale nuk janë vërtetuar veprimet inkriminuese. Mbrojtja më tej ka theksuar se sa i përket dëshmitarit L.N. të cilin prokuroria e konsideroj si provë kryesore sa i përket të mbrojturit të tij në asnjë mënyrë nuk ka vërtetuar asnjë element inkriminues për të njëjtin, ngase ky dëshmitar ka shpjeguar se si njihej me të mbrojturin e tij duke shpjeguar raportet mes tyre me këtë, duke vërtetuar se të dy janë konsumues të kokainës por nuk e vërteton se i mbrojturi i tij e ka furnizuar këtë dëshmitar me narkotik, sepse këto rrethana nuk e qartësojnë, por vërtetojnë faktin se ai ka poseduar narkotik dhe e kanë konsumuar së bashku. Gjithashtu ky dëshmitar nuk e ka vërtetuar faktin sa i përket raporteve të të

mbrojturit të tij me B., apo faktin se a ka siguruar narkotik i mbrojturi i tij nga i pandehuri B..

- Gjithashtu edhe sa i përket provave materiale siç janë bisedat telefonike në mes të mbrojturit të tij dhe të pandehurit B., ato biseda sipas mbrojtjes nuk vërtetojnë asgjë konkrete sepse janë biseda të paqarta e që në dukje të parë krijojnë përshtypje se në mes tyre ekziston një raport i caktuar, dyshohet më tepër si një raport që ka të bëjë me ndonjë huamarrje apo raport për kryerjen e një veprimi të caktuar nga jeta e përditshme, por në asnjë mënyrë nuk vërtetohet se ka të bëjë me shitblerje të substancave narkotike. Mbrojtësi më tej ka shtuar se sa i përket bastisjes në shtëpinë e të mbrojturit të tij nuk ka rezultuar me sigurimin e asnjë prove që ka të bëjë në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i tij, por dihet se çdo herë qëllimi i bastisjes si veprim operativo- hetimor, realizohet për të siguruar ndonjë provë materiale e sidomos që vërtetojnë përgjimet që janë bërë ndaj të mbrojturit të tij.
- Mbrojtja ka shtuar se i mbrojturi i tij nuk është kryerës i veprës penale të pretenduar dhe derisa mungon kryerja e veprës vetë organizimi pa një qëllim të caktuar të vetëm si struktura abstrakte nuk mund të paraqet as veprë penale edhe nën supozimin se është kryerës i veprës penale nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK. Kjo nuk do të thotë se ka të bëjë me krim të organizuar në këtë rast konkret. Sa i përket raportit dhe bisedave në mes të mbrojturit të tij dhe të pandehurit B.I., mbrojtja ka shtuar se ato biseda dhe kontakte fizike kane qenë në mes të dy bashkëvendësve, ka qenë raport shoqëror dhe familjar e që prokuroria i ka interpretuar gabimisht si organizim i grupit kriminal. Mbrojtja më tej ka cekur se në rastin konkret nuk janë përmbushur kriteret që kërkohen për t'i trajtuar veprimet e të pandehurve si veprime të grupit kriminal e të cilat kriteret kërkohen edhe me konventat ndërkombëtare e që sipas mbrojtjes në këtë rast nuk ka të bëjë fare me krim të organizuar, ngase prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë asnjë element së paku formal që përbënë apo mund të trajtohet si element përbërës i grupit kriminal apo krimi të organizuar.
- Nga provat e aktakuzës sa i përket veprës penale me të cilën ngarkohet i mbrojturi i tij, mbrojtësi konsideron se janë të pamjaftueshme dhe të pabesueshme për të rrezuar prezumimin e pafajësisë të mbrojturit të tij, andaj pa-besueshmëria dhe pamjaftueshmëria e provave përjashtojnë përgjegjësinë penale të mbrojturit të tij për veprën penale që i vihet në barrë përkundrazi përgjegjësia penale për veprën për të cilën akuzohet e bëjnë të dyshimtë, andaj kur çështja faktike paraqitet e dyshimtë duhet vendosur në favor të të pandehurit sipas parimit “in dubio pro reo”. Mbrojtja krejt në fund ka kërkuar nga gjykata që të merr një vendim lirues ngase prokuroria nuk ka arritur t'i provoj faktet apo pretendimet e ngritura në aktakuzë sa i përket të mbrojturit të tij.

I akuzuari **U.Q.** në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke theksuar se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër nga ajo që ka deklaruar mbrojtësi i tij.



I akuzuari **M.I.**, respektivisht mbrojtësja e tij Avokate Sh. M. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas administrimit të të gjitha provave në shqyrtimet gjyqësore prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj dhe argumentoj me prova konkrete e bindëse apo të mjaftueshme pretendimet e theksuara si në aktakuzë apo se ato pretendime kanë qenë të ngritura mbi supozime sa i përket të mbrojturit të saj.
- Mbrojtësja ka theksuar se në mënyrë të qartë janë të përkufizuara kushtet ligjore-elementet qenësore të veprës penale që duhet të plotësohen për tu ngritur një aktakuzë dhe vërtetuar pretendimet akuzuese ndaj një të pandehuri, duke u mbështetur e argumentuar me prova të mjaftueshme, konkrete dhe bindëse. Sa i përket të mbrojturit të saj, akuza nuk ka mbështetje të mjaftueshme në prova konkrete ngase fillimisht për tu plotësuar tiparet e figurës së veprës penale nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, duhet që me veprimet e të pandehurit të ekzistojë dhe vërtetohet qëllimi-dashja e dijenia për veprimtarinë e përgjithshme të grupit kriminal të strukturuar për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim si dhe i pandehuri të ndërmerr veprimet inkriminuese në atë drejtim në mënyrë aktive për realizimin e veprimtarive të grupit kriminal të organizuar e strukturuar. Kjo do të thotë se duhet që ai B. i strukturuar të ekzistoj për një kohë të caktuar prej tre e më shumë persona, e me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore dhe që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, gjithashtu për tu plotësuar tiparet e figurës së veprës penale nga neni 267 paragrafi 2 dhe 268 paragrafi 1 të KPK, duhet që në veprimet e të pandehurit të ekzistoj dhe vërtetohet qëllimi-dashja për prodhim, kultivim dhe shitje të substancave narkotike, që i pandehuri të ndërmerr veprime inkriminuese në atë drejtim e për krejt këtë mbrojtja konsideron se prokuroria në rastin konkret gjatë seancave gjyqësore sa i përket të mbrojturit të saj nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete e të mjaftueshme dhe bindëse si dhe të pranueshme në aspektin ligjore, faktin se tek i mbrojturi i saj janë plotësuar elementet, tiparet e veprës penale.
- Mbrojtja konsideron se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet kjo as nga deklaramet e të dy dëshmitareve të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, përgjigjet telefonike, SMS dhe regjistri i thirrjeve etj., të cekura në arsyetim të akuzës ndaj të mbrojturit të saj nuk mund të konstatohet as vërtetohet se i njëjti ka ndërmarr veprimet inkriminuese. Mbrojtja në fund ka shtuar se pretendimet e prokurorisë ndaj të mbrojturit të saj nuk janë vërtetuar as nga deklarimi i dëshmitarëve, procedimi i gjitha provave materiale e as nga procedimi i të gjithë të akuzuarve në shqyrtim gjyqësor duke kërkuar nga gjykata që të merr parasysht parimin “in dubio pro reo”, sepse mbrojtja konsideron se i mbrojturi i saj nuk mund të shpallet penalisht përgjegjës, duke propozuar gjykatës që të njëjtin ta liroj nga akuza pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet sipas aktakuzës, njashtu ka propozuar që automjeti i markës “Smart” i sekuestruar nga bashkëshortja e të

mbrojturit të saj t'i kthehet, sepse është pronë e saj dhe nuk është përdorur për shitblerje të substancave narkotike.

I akuzuari **M.I.** në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke theksuar se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër nga ajo që ka deklaruar mbrojtësi i tij.

I akuzuari **Sh.I.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat I. S. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Prokuroria ka për obligim që në fjalën e vet përfundimtare bazuar në nenin 353 të KPPRK të paraqes vlerësimin e vet rreth provave të nxjerra në seancën kryesore dhe të paraqes konkluzionet e veta mbi faktet e rëndësishme që rezultojnë nga ato prova e që konkluzionet e prokurorisë mbi faktet e rëndësishme nuk rezultojnë si prova nga provat e administruara për të mbrojturin e tij, duke shtuar se prokuroria deri në fund të procedurës nuk ka siguruar apo prezantuar ndonjë provë të re për të vërtetuar tezën e akuzës sa i përket veprave penale me të cilat ngarkohet i mbrojturi i tij. Mbrojtja ka theksuar se akuzës së prokurorisë që në fillim i kanë munguar referencat kryesore, koha e kryerjes së veprës penale, vendi i kryerjes së veprës penale, lidhja klauzale eventuale në mes të veprimit dhe mos veprimit e pasojës juridike, duke konsideruar se organi i ndjekjes nuk ka ofruar prova materiale e as formale në këtë gjykatë për të vërtetuar pretendimin se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprat penale, pra një pretendim i tillë ishte vetëm një thënie e pabazuar në prova materiale.
- Sa i përket provave materiale që kanë të bëjnë në lidhje me të mbrojturin e tij, mbrojtësi konsideron se ato prova janë marr në kundërshtim me nenin 92 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPRK, për faktin se urdhër arresti i lëshuar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, nuk përmban emrin dhe mbiemrin e të mbrojturit të tij përkatësisht i njëjti nuk ka qenë subjekt i urdhëresës në fjalë. Përveç provave materiale të propozuara nga prokuroria pretendimi se i mbrojturi i tij nuk ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, nuk është vërtetuar as nga deklarata e dëshmitarëve e të njëjtat kanë qenë kundërthënëse, jo kredibile, të paargumentuara dhe si të tilla janë të pa pranueshme e as pa mbështetje në fakte dhe arsye ligjore. Sa i përket pretendimit të prokurorisë për bashkëkryerje, mbrojtja ka shtuar se as ku pretendim i prokurorisë nuk qëndron për faktin se kjo është sqaruar në tërësi dhe për këto vepra penale jo që nuk është bashkëkryerës por nuk është involvuar fare. Mbrojtësi krejt në fund ka shtuar se pas gjitha seancave gjyqësore dhe dëshmive të paraqitura është vërtetuar se e tërë kjo çështje nuk ka fare elemente të veprës penale dhe nga provat e administruara është vërtetuar pafajësia e të mbrojturit të tij, duke i propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza në mungesë të provave materiale dhe formale.

### **Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin:**

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, së pari do ta shtjelloj: vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale e për të cilën të

akuzuarit janë shpallur fajtor; cilësimin juridik të veprës penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale; provat dhe faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjendja fajtor e të akuzuarve; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; çështjen e konfiskimit, dënimit dhe të shpenzimeve procedurale.

*Gjendja faktike dhe cilësimi juridik në raport me gjendjen faktike:*

Gjykata, në këtë çështje penale ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë në përshkrim të shkurtër se të akuzuarit nga periudha kohore e pacaktuar e deri më 24.12.2021 në fshatin ... të Komunës së Gj., respektivisht në shtëpitë e tyre familjare, të akuzuarit B.I., Sh.I. dhe i akuzuari në arrati F.M., pa autorizim kanë prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerr në qarkullim-për shitje substancë narkotike. Substancën e kultivuar narkotike të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”, fillimisht i akuzuari B.I. i ka siguruar farat për mbjelljen e këtij narkotiku, farat i ka siguruar nga një person me shtetas gjerman e më pas së bashku me të akuzuarit Sh.I. e F.M. (i cili gjendet në arrati) e kanë kultivuar këtë narkotik, e kanë vënë në qarkullim me qëllim shitjeje edhe përmes të akuzuarve po të këtij rasti penal, të akuzuarve U.Q. e M.I.. Me rastin e kontrollit të shtëpive të të akuzuarve B. e Sh.I., është gjetur në shtëpitë e tyre sasi e konsiderueshme e narkotikut, veglapajisje për kultivim e përpunim të narkotikut, fara për mbjellje të narkotikut, peshore për peshimin e narkotikut dhe peshore me mbetjeje të pluhurit të bardhë “Kokainë”.

Prokuroria Speciale, me rastin e ngritjes së aktit akuzues, të akuzuarit e kësaj çështjeje penale i ka akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK e lidhur me veprën penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 1 të KPRK.

Po ashtu i akuzuari B.I., është akuzuar edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, ku për këtë vepër penale, gjykata nuk ka bërë ri-cilësim të veprës penale por ka vetëtuar se gjendja faktike në raport me këtë vepër penale është provuar sikurse ajo e pretenduar me aktin akuzues.

Gjendja e lartë-theksuar faktike të përshkruar në përshkrim të shkurtër në këtë arsyetim të aktgjykimit, por edhe gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, është gjendje të cilën e ka vërtetuar gjykata me rastin e procedimit të kësaj çështjeje penale dhe provave të saj. Bazuar në këtë gjendje faktike, gjykata ka bërë ri-cilësimin juridik të veprës penale, nga ai cilësim i veprës i cili është parashtruar me aktin akuzues (respektivisht pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar) në veprën-veprat penale për të cilën-cilat janë shpallur fajtor të akuzuarit.

Gjykata, konsideron se gjetjet gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e kanë vërtetuar veprën penale pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 i KPRK, por në rastin konkret ka vërtetuar se të akuzuarit: **1)** B.I. dhe Sh.I., kanë kryer veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPRK; **2)** M.I., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK; **3)** U.Q., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe **4)** A.Z., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata, sa i përket ri-cilësimit të veprës penale për shkak të mos gjetjes së veprës penale të krimit të organizuar, do ta bëjë elaborimin më poshtë.

Për të ekzistuar vepra penale e krimit të organizuar, nevojitet të përmbushen disa parakushte apo karakteristika, të cilat karakteristika janë të akceptuara edhe në përkufizimin ligjor të veprës penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga nen 277 të KPRK.

Pra, për të ekzistuar krimi i organizuar, duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore, pa të cilat nuk mundë të ekzistoj krimi i organizuar si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat e formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë të krimit të organizuar janë: **1)** përfshirja e tre apo më shumë personave si grup i organizuar kriminal; **2)** për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; **3)** të dyshuar apo të dën timer për vepra penale të rënda (për të cilat përcaktohet dën timer me 4 katër vite burgim apo më shumë) dhe **4)** me qëllim të përfitimit material apo të pushtetit <sup>1</sup>.

Përpos karakteristikave mandatore për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi i ekspertëve të KE, ka përcaktuar edhe karakteristikat alternative e të cilat duhet së paku dy nga to të plotësohen. Ku si karakteristika alternative konsiderohen: **1)** të ketë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar të grupit; **2)** përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm; **3)** përdorin dhunë ose forma tjera frikësuese; **4)** ushtrojnë ndikim tek politika, mediat, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit, etj.; **5)** përdorin strukturë tregtare ose të ngjashme me biznesin; **6)** janë të përfshirë në pastrim parash; **7)** operojnë në nivel trans-nacional.

Pra këto janë karakteristikat-elementet kyçe që duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale të krimit të organizuar, të cilat karakteristika-elemente i kanë akceptuar dhe instrumentet

---

<sup>1</sup> Lis of Characteristics of Organized Crimes / Experts of Council of Europe - Lista e Karakteristikave të Krimit të Organizuar / Ekspertët e Këshillit të Evropës;  
UN Convention on Transnational Organized Crime (General Assembly Resolution 55/25 of 15 November 2000) - Konventa e OKB për Krimin e Organizuar Transnacional (Rezoluta 55 /25 e 15 nëntor 2000 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB;  
<https://www.unodc.org/e4j/en/organized-crime/module-1/key-issues/activities-organization-composition.html>

me të rëndësishme ndërkombëtare në definimin e krimit të organizuar, instrumentet e theksuara dhe në referencë të këtij aktgjykimi.

Me rëndësi është të theksohet se këto elemente a janë plotësuar në rastin konkret, respektivisht në veprimet e të akuzuarve në këtë çështje penale. Në raport me faktin se a janë plotësuar këto elemente në veprimet e të akuzuarve, gjykata do i elaboroj më poshtë:

- Nuk ka dilemë se në rastin konkret kemi të përfshirë në këtë vepër penale më shumë se tre persona, por nuk kemi të bëjmë me grup-kriminal të organizuar, por me kemi të bëjmë me disa të akuzuar të cilët në bashkëkryerje e në vazhdimësi i kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor. Pra në veprimet e tyre të ndërmarra në drejtim të kryerjes së veprës penale nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kanë qenë grup i organizuar kriminal me strukturë të organizuar, strukturë të organizuar kriminale në drejtim të kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohen. Për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi prej tre e më shumë personave duhet të jetë grup kriminal i organizuar e jo një përbërje e thjeshtë prej tre e më shumë personave<sup>2</sup>, pra jo si në rastin konkret ku të akuzuarit kanë pasur bashkëpunim ndërmjet vete në kryerjen e veprës penale apo veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor, ku këtë bashkëpunim e ka lidhur më shumë interesi në kryerjen e veprës penale, lidhje e tyre familjare e shoqërore e jo organizimi i tyre në stadin e një grupi të organizuar kriminal për të kryer vepra penale të rënda ashtu si kërkohet nga instrumentet ndërkombëtare të cilat e definojnë dhe sanksionojnë krimin e organizuar. Instrumentet ndërkombëtare të cilat po ashtu janë të inkorporuar në legjislacionin tonë penal, respektivisht janë kërkesa të nenit 277 të KPRK;
- Grupi kriminal i organizuar<sup>3</sup> është përcaktuar si grupi strukturuar i tre e më shumë personave i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, ndërsa në rastin konkret, gjykata, nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk kemi pasur një grup mirëfilli të organizuar me një strukturë udhëheqëse, ku definitivisht është ditur se kush është lideri i grupit, kush jep urdhër, kush janë zbatuesit e këtyre urdhrave dhe cilat janë detyrat e ndara për çdonjërin anëtar të grupit;
- Nga provat e administruara nuk vërtetohet se kush është lideri i grupit i cili jep urdhra dhe se anëtarët tjerë t'i binden urdhrave të tij. Prokuroria Speciale me aktin akuzues të saj të akuzuarit i ka akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, që nënkupton se të gjithë të akuzuarit janë të akuzuar për pjesëmarrje në krim të organizuar, por asnjëri nga ta nuk është i akuzuar për organizim dhe udhëheqje të krimit të organizuar ashtu si e kërkon paragrafi 2 i po këtij neni, e që nënkupton se të gjithë janë pjesëmarrës në krim të organizuar, mirëpo se kush e udhëheqë këtë krim të organizuar nuk e ka potencuar fare në akt akuzues (pra askush nuk është akuzuar për rolin organizativ e të kontrollit të krimit të organizuar). Marrë në konsideratë se kërkesë-kriter i instrumenteve ndërkombëtare e po ashtu edhe i legjislacionit

---

<sup>2</sup> Neni 2 i Aneksit të Konventës së OKB për Krimin e Organizuar Trans-nacional;

<sup>3</sup> Shih fusnotën 2;

tonë është se për të ekzistuar krimi i organizuar duhet të ekzistoj organizata kriminale me udhëheqje, anëtarësi e me role të ndara-përcaktuara, andaj edhe në aktin akuzues prokuroria është dashur t'i qartësoj këto kërkesa ligjore, t'i provoj me prova dhe në fund gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor t'i vërtetoj si të qena. Prokuroria me provat e parashtruara me aktin akuzues nuk ka vërtetuar këto fakte, respektivisht strukturën organizative të grupit kriminal të organizuar e as ekzistencën e këtij grupi, ku edhe me aktin akuzues të gjithë të akuzuarit i ka akuzuar për pjesëmarrje në krim të organizuar, por pa definuar strukturë organizative, pa definuar rolin e çdo të akuzuari brenda krimit të organizuar, pa definuar udhëheqjen e krimit të organizuar, pra pa i identifikuar elementet e kërkuara në paragrafin 1 e 2 të nenit 277 të KPRK, për organizimin, themelimin, mbikëqyrjen e menaxhimin dhe pjesëmarrjen në krim të organizuar;

- Të akuzuarit kanë vepruar për një periudhë kohore të limituar dhe atë përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo nuk mund të thuhet se kanë vepruar për një periudhë të gjatë kohore për ta ushtruar veprimtarin kriminale, respektivisht nuk kanë vepruar për një periudhë kohore e cila mundë të cilësohet si ndërmarrësi kriminale<sup>4</sup> në drejtim të kryerje së një veprë të një natyre të caktuar apo veprave të natyrave të ndryshme kriminale, me qëllimin e përfitimit material;
- Nga të lartë-theksuar, me plotë kuptim, gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret nuk kemi pasur të bëjmë me ndonjë grup të organizuar kriminal, por me disa të akuzuar të cilët disa kanë vepruar së bashku por pa ndonjë organizim të mirëfilli në formë të krimit të organizuar. Andaj, gjykata ka bërë ri-cilësimin e veprës penale nga cilësimi juridik i bërë nga organi akuzës në veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor të akuzuarit, respektivisht vepra penale të narkotikëve por jo krim i organizuar.

#### Fajësia e të akuzuarve në raport me gjendjen faktike:

Deri më tani në arsyetim të aktgjykimit është shtjelluar gjendja faktike të cilën gjykata e ka provuar me provat e administruar në këtë çështje penale. Gjukata me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike me këtë aktgjykim, ka vërtetuar se të akuzuarit nuk janë përgjegjës për veprën penale të krimit të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPRK, ashtu si pretendon akti akuzues, por për veprat penale të ri-cilësuar sipas këtij aktgjykimi. Aktgjykimi në pjesën e lartë-theksuar ka shtjelluar-analizuar faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me krim të organizuar, ndërsa në pjesën e mëposhtme do të shtjelloj-analizoj gjendjen faktike në raport me të akuzuarit (secilin prej tyre), fajësinë e tyre dhe provat me të cilat është vërtetuar fajësia e tyre.

Gjukata në këtë çështje penale ka administruar një sërë provash personale e materiale e nga të cilat prova ka vërtetuar gjendjen faktike-respektivisht gjendjet faktike sikurse në këtë aktgjykim.

Gjukata nga provat e administruara në këtë çështje penale, ka administruar:

---

<sup>4</sup> Ndërmarrësi kriminale - criminal enterprise e definuar sipas Konventës së OKB.

Provat materiale:

1. Raporti përmbledhës i vëzhgimit të pandehurve i datës 31.01.2022. Raport sipas Urdhëresës për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende private dhe shfrytëzim i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes me “GPS” (Urdhëresat e datës 29.09.2021 dhe 01.12.2021);
2. Raporti i datës 12.10.2021, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, vendosjes së mjeteve për përcjellje “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të të akuzuarve B.I., F.M. dhe A.Z.;
3. Raporti i datës 17.10.2022, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private me mjete për përcjellje të vendndodhjes me “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të të akuzuarve B.I., F.M. dhe A.Z. (Urdhëresat e datës 17.09.2021 dhe 02.11.2021);
4. Raporti i datës 24.10.2021, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private përmes mjeteve për përcjellje të vendndodhjes “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të të akuzuarve B.I. dhe M.I.;
5. Raporti i datës 01.11.2021, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë në vende private me përmes mjeteve për përcjellje të vendndodhjes “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të akuzuarit F.M. dhe personit NN;
6. Raporti i datës 25.10.2021, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë në vende private me përmes mjeteve për përcjellje të vendndodhjes “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të akuzuarve B.I. dhe Sh.I.;
7. Raporti i datës 01.10.2021, transkriptimi i bisedave nga monitorimi i fshehtë në vende private me përmes mjeteve për përcjellje të vendndodhjes “GPS” në automjetin “BMW” me targa ..., monitorimi i bisedave të akuzuarve B.I. dhe U.Q.;
8. Transkriptim i bisedave të siguruara me masa të fshehta teknike të vëzhgimit e hetimit (përgjim i telekomunikimeve), masa të lëshuara ndaj të akuzuarit B.I., komunikime të datave 01.10.2021 (09:21-09:22:45); 11.10.2021 (11:50:19); 12.10.2021 (00:00:26); 22.10.2021 (16:17:03); 02.12.2021 (12:06:53). Përgjime të telokunikimeve përmes Urdhëresës nën numrin PPR.nr.174/21 e datës 26.10.2021 për numrin e telefonit ...;
9. Transkriptim i bisedave të siguruara me masa të fshehta teknike të vëzhgimit e hetimit (përgjim i telekomunikimeve), masa të lëshuara ndaj të akuzuarit M.I., komunikime të datave 05.11.2021 (18:08:15); 12.11.2021 (19:16:13); 25.10.2021 (15:51:19); 26.10.2021 (21:51:31); 30.10.2021 (14:42:28) 07.12.2021 (19:10:20). Përgjime të telokunikimeve përmes Urdhëresës nën numrin PPR.nr.174/21 e datës 20.10.2021, për numrin e telefonit ...;

10. Transkriptim i bisedave të siguruara me masa të fshehta teknike të vëzhgimit e hetimit (përgjim i telekomunikimeve), masa të lëshuara ndaj të akuzuarit Sh.I., komunikimeve të datës 16.12.2021 (10:47:57). Përgjime të telokuminikimeve përmes Urdhëresës nën numrin PPR.nr.174/21 e datës 01.12.2021, për numrin e telefonit ...;
11. Transkriptim i bisedave të siguruara me masa të fshehta teknike të vëzhgimit e hetimit (përgjim i telekomunikimeve), masa të lëshuara ndaj të akuzuarit U.Q., komunikimeve të datës 15.12.2021 (16:59:33). Përgjime të telokuminikimeve përmes Urdhëresës nën numrin PPR.nr.174/21 e datës 14.12.2021, për numrin e telefonit ...;
12. Raporti i kontrollit të objekteve të banimit dhe objekteve përcjellëse të të akuzuarve i datës 24.12.2021;
13. Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim i datës 24.12.2021. Kontroll në objektet e banimit dhe objektet përcjellëse të të akuzuarit B.I. (së bashku me foto-album);
14. Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim i datës 24.12.2021. Kontroll në objektet e banimit dhe objektet përcjellëse të të akuzuarit Sh.I. (së bashku me foto-album);
15. Raporti i ekspertimit, ekzaminimi i llojit të bimëve narkotike me numër AKF/2022-0010/2022-11 i datës 24.02.2022;
16. Raporti i ekspertimit të pajisjeve elektronike i datës 31.08.2022;
17. Ekzaminimet e pajisjeve elektronike i datës 25.08.2022;
18. CD me përmbajtje të videove e fotove të siguruara nga rrjetet sociale “Snapchat” nga telefoni i të akuzuarit M.I., telefon i markës “Samsung Galaxy S9”;
19. Raportet e vëzhgimit të të akuzuarve për periudhën kohore nga data 04.10.2021 deri më datë 21.12.2021;
20. Raporti mbi sekuestrimit e municionit (fishekëve) të sekuestruar e të konfiskuar me këtë aktgjykim i datë 14.09.2022;
21. Urdhri për sekuestrim të përkohshëm dhe sendet-provat e pasuria e sekuestruar me urdhër për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PPr.nr.174/21 i datës 19.01.2022;

Provat personale:

22. Deklaratat e dëshmitarit G. G. të dhëna gjatë fazës së hetimit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;



23. Deklaratat e dëshmitarit L.N. të dhëna gjatë fazës së hetimeve dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;
24. Deklarata e dëshmitarit S. M. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
25. Deklaratat-mbrojtja e të akuzuarit B.I. të dhëna gjatë fazës së hetimeve (Polici dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës) dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;
26. Deklaratat-mbrojtja e të akuzuarit Sh.I. të dhëna gjatë fazës së hetimeve (Polici dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës) dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;
27. Deklaratat-mbrojtja e të akuzuarit M.I. të dhëna gjatë fazës së hetimeve (Polici dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës) dhe qëndrimi i tij në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor;
28. Deklaratat-mbrojtja e të akuzuarit U.Q. të dhëna gjatë fazës së hetimeve (Polici dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës) dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;
29. Deklaratat-mbrojtja e të akuzuarit A.Z. të dhëna gjatë fazës së hetimeve (Polici dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës) dhe qëndrimi i tij në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor;

*Të akuzuarit B.I. e Sh.I:*

Gjykata këta të akuzuar i ka gjetur fajtor për veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPRK.

Gjykata, nga provat e administruara pa mëdyshje ka vërtetuar e gjetur se këta dy të akuzuar së bashku me të akuzuarin në arrati F.M., pa autorizim kanë prodhuar lëndë narkotike të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”.

Se këta dy të akuzuar kanë prodhuar lëndë narkotike në shtëpitë e tyre në fshatin ... të Komunës së Gj., ku gjatë kontrollit të shtëpive të tyre janë gjetur sasi narkotiku, vegla për përpunimin e narkotikut e po ashtu edhe peshore me të cilat është bërë matja e ndarja e narkotikut në sasi për shitje.

Gjatë kontrollit<sup>5</sup> të shtëpive të banimit të të akuzuarve B. e Sh.I. në fshatin ... të Komunës së Gj., është gjetur sasia e narkotikut e përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe vegla për terjen e përpunimin e narkotikut. Ku në shtëpinë e banimit të B.I., respektivisht në pjesën e

---

<sup>5</sup> Procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i datës 24.12.2021 nën numrin 2021-DHTN-333 (duke përfshirë edhe urdhrat për sekuestrim).

verandës e pritjes ashtu si edhe është definuar në skicën e kontrollit e në foto-dokumentacion, është gjetur sasia e narkotikut e futur në gavanoza të qelqit dhe qese plastike. Ndërsa në kontrollin e pjesës së objekteve përcjellëse (garazh dhe objekt i ndërtuar mbi garazh) është gjetur narkotik dhe vegla për përpunimin-terjen e narkotikut. Po ashtu në pjesën e jashtme të shtëpisë, respektivisht në oborrin e shtëpisë është hasur në serën prej plast-mase në të cilën janë kultivuar bimët e narkotikut e të cilat më pastaj janë përgatitur për treg dhe shitje.

Kontroll i shtëpisë dhe objekteve përcjellëse është bërë edhe në shtëpinë e Sh.I. në fshatin ... të Komunës së Gj., ku gjatë kontrollit po të datës 24.12.2021, janë gjetur sasi të narkotikut, vegla e pajisje për përpunimin e narkotikut. Në këtë kontroll, po ashtu edhe tek ky i akuzuar janë gjetur vegla e pajisje për përpunimin e narkotikut dhe atë gërshtë për prerje/krasitje të narkotikut dhe sasi të narkotikut e cila është përpunuar e përgatitur për shitje. Tek ky i akuzuar, po ashtu është hasur edhe peshorja e cila është shfrytëzuar për peshimin e narkotikut por edhe nga analizat forenzike ka rezultuar se në këtë peshore është bërë edhe peshimi i substancës narkotike të kokainës.

Materiali i cili është sekuestruar e më pastaj konfiskuar me këtë aktgjykim, nga analizat e laboratorit të forenzikës ka rezultuar që të jetë lëndë narkotike dhe atë e llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë”, ndërsa mbetjet me ngjyrë të bardhë të gjetura në peshore kanë rezultuar të jenë mbetje të kokainës.

Përpos Raportit të ekspertimit të bërë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë nën numrin AFK/2022-0010/2022-11, po ashtu në seancën e mbajtur me datë 12.06.2023, eksperti-zyrtari i kësaj agjencie, S. M. është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit i cili në deklaratimet e tija ka konfirmuar raportin e forenzikës lidhur me përmbajtjen e substancave narkotike, ku sërish ka theksuar se sasi e gjetur e narkotikut ka të bëjë me përmbajtje të narkotikut të llojit “Kanabis Sativa-Marihuanë” dhe se pluhuri i bardhë i gjetur në peshore rezulton me substancë narkotike “Kokainë”.

Pra, gjykata nga raportet e kontrollit dhe nga analiza laboratorike e substancës narkotike të gjetur në kontroll, ka vërtetuar se sasia e narkotikut e theksuar sikurse në dispozitivt këtij aktgjykimi, është gjetur në shtëpitë e këtyre dy të akuzuarve e po ashtu edhe është konstatuar se është substancë narkotike.

Gjykata, për ta vërtetuar faktin se ky narkotik i gjetur në shtëpitë e të akuzuarve, se është kultivuar nga të akuzuarit dhe se këta të akuzuar këtë lëndë narkotike e kanë përgatitur për shitje dhe e kanë shitur, këto fakte i ka vërtetuar me administrimin e provave si ato materiale e po ashtu edhe ato personale.

Nga përgjimet e telekomunikimeve e po ashtu edhe nga përgjimi i bisedave përmes pajisjeve GPS, biseda dhe komunikime të ndodhura ndërmjet të akuzuarve për kultivimin dhe shitjen e narkotikut, rezulton se të akuzuarit B. e Sh.I., e kanë bërë kultivimin e narkotikut e më pastaj

këtë narkotik vet personalisht apo edhe përmes të akuzuarve tjerë (duke përfshirë edhe të akuzuarin në arrati, F.M.) e kanë shitur këtë substancë narkotike<sup>6</sup>.

Nga komunikimet e bëra nga këta të akuzuar, respektivisht B. e Sh.I. (komunikime të vërtetuara përmes masës hetimore të përgjimit të komunikimit dhe vendndodhjes), vërtetohet qartë se këta dy të akuzuar jo vetëm se e kanë kultivuar këtë narkotik por të njëjtin e kanë përgatitur për treg dhe e kanë shitur duke furnizuar persona të tjerë me këtë lëndë narkotike. Këto komunikime, kanë ndodhur ndërmjet të akuzuarve të kësaj çështjeje penale, por edhe me persona të tjerë të cilët janë furnizuar me narkotik nga këta të akuzuar apo kanë qenë pjesë e kultivimit dhe shitjes së narkotikut.

Nga komunikimet e më poshtme të të akuzuarve B. e Sh.I., vërtetohet gjendja faktike-pretendimet e këtij aktgjykimi dhe atë:

Komunikimi i datës 12.10.2021 i bërë në ora 18:30 minuta, ndërmjet B.I. dhe F.M., dëshmon kultivimin e narkotikut po edhe shitjen e tij dhe atë këta të akuzuar komunikojnë ndërmjet vete, F. “a i vjerre”, B. “po i vjerra, por krejt kishin fillu mu myk”, F. “po a e”, B. “e kap kështu fletat njana me tjetrën”, F. “po de”, B. “u dasht krejt me i vjerr, po hjeqa po kadal dal u dasht me i vjerr”, F. “a i vjerre nalt te shpia zjermit”, B. “po te shpija zjermit”, F. “sa dalin more a thu B. qaty”, B. “po spo di sa dalin ma merr mendja 3-4 killa (kg)”, F. “jo ma shumë”, B. “ani tash e sheh po të thash edhe jon daj”, F. “po spo thom gjama 3-4 killa pak”, B. “o pasha Kuranin e pasha”, F. “o mos bo be”, B. “dektë E. I. ni boq a ni deg”, F. “o a ka mundesi mos me ba be bre”, B. “o daj po qysh ki jep i sheh vjerr”, F. “o daj bre”, B. “përafërsisht se kur po u letojshin kur i kom pa ato të mijat a din me degë”.

Nga kjo pjesë e komunikimit të B.I. me F.M., shihet qartë se si B. e F., kanë qenë të angazhuar në kultivimin e kundërligjshëm të lëndëve narkotike me qëllim të shitjes së tyre dhe atë duke komunikuar se si duhet kultivuar narkotikun e përgatitur në kilogram për qëllim shitjeje.

Këta dy të akuzuar flasin edhe për mbjelljen e narkotikut në një vend tjetër, mbrapa shtëpisë së një personi ku i kanë mbjellur 500 rrënjë narkotiku me qëllim të shitjes, ku nga këto komunikime shihet fare qartë se i akuzuari B.I., është marrë me kultivim të narkotikut dhe atë jo vetëm tek shtëpia e tij por edhe në vende tjera dhe atë me qëllim të shitjes. Këta të akuzuar flasin edhe për një person “Xh.” me të cilin nuk janë dakorduar për prerjen e narkotikut, ku duke u transportuar kanë hasur në polici dhe se kanë tentuar t’i hedhin në rrugë e më vonë të vijnë e t’i marrin, por se si F. i ka bindur që të mos i hedhin. Pra nga komunikimet e kësaj date, ku i akuzuari B., komunikon me të akuzuarin në arrati F., F. “tha Xh. po i qojm diku pi terim qito edhe kqyrim sa dalin a pe din”, B. “për qeto dy tre copa po ato a janë kanë 500 rraje”.

Komunikime të ndodhura ndërmjet të akuzuarve, nuk janë vetëm komunikimet ndërmjet B.I. dhe F.M., po komunikime edhe ndërmjet të akuzuarit B. dhe të akuzuarit A.Z., ku këta të akuzuar

---

<sup>6</sup> Provat e administruara të theksuara në këtë aktgjykim nën numrin 2 deri në 11.

komunikojnë për shitjen e narkotikut dhe sigurimin e tij, e të cilat shitje i dedikohen personave të tjerë të cilëve këta të akuzuar kanë pasur t'ua ofrojnë për shitje.

Me datë 12.10.2021 dhe atë rreth orës 16:43 minuta, në komunikimet të cilat i kanë pasur të akuzuarit B. dhe A., ku B. i “ku je daja G. a ke gjet naj myshteri të mirë a”, A. “jo veq te marrim naj copë te kqyrim, ka disa lloje se afat i ke perzi ti”, B. “daj ka, qe po ta jepi besën e Zotit qe kur nuk ki pas qasi bari hiq asnjëhere”, A. “a i ke nuk ato qe i ki, mos i le si atëherë qe i ke lan se si dihet”, B. “nuk me han hiq, tu betohna se nuk e din kerkush qe i kom veq ty te kom kështu per zemër edhe hiq ski nevoj kerkujna mi thon, thuj ne P. ose P. e kum marr”, A. “jo jo hajt ti, une ju thom prej Shqiperise e kom marr”, B. “ama kurr ne jetën tane ske pas asi bari”.

Nga këto komunikime të të akuzuarit B. me të akuzuarin A.Z., pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari B., ka kultivuar bimë narkotike dhe se për këto kultivime ka qenë i njoftuar edhe i akuzuari A., i cili ka kontaktuar me persona të tjerë për shitjen e narkotikut, ku e diskutojnë me të akuzuarin B., cilësinë e narkotikut dhe se si personave të cilët i kanë furnizuar me narkotik t'i thonë se narkotiku nuk kultivohet tek këta por është marrë nga dikush tjetër, me qëllim të t'i zhdukin gjurmët me persona të tjerë që të mos e kuptojnë se ku po kultivohet dhe se të besojnë se kualiteti është i mirë, ku i akuzuari B. i thotë të akuzuarit A., thuaj se narkotiku e ke siguruar nga dikush nga P. apo P., ndërsa A. i thotë se jo do t'i them se e kam siguruar nga Shqipëria, që të mos kuptohet se ku është siguruar dhe se ka kualitetin e duhur. Këta të akuzuar në komunikimet e tyre, bisedojnë edhe për faktin se si një vit më parë iu ka shkuar puna huq nga mbjellja e narkotikut dhe atë se mos rastësishtë edhe ky vit po ju shkon njejtë, por i akuzuari B. i përgjigjet të akuzuarit A., se sivjet do t'iu shkoj më mire dhe atë kualiteti është shumë i mirë, po ashtu kanë komunikuar edhe për kultivimin e narkotikut në ambiente të pajisura me drita speciale për kultivimin e narkotikut.

Ndërsa se i akuzuari B.I., ka komunikuar me A.Z., për shitjen e këtij narkotiku të kultivuar dhe atë duke diskutuar për çmimin për kilogram dhe atë duke i theksuar A. se për kualitete edhe më të dobëta janë dhënë shuma edhe më të mëdha.

Në komunikimet e tyre ata kanë biseduar për çmime, B. “ka shanca daj njeri pesëmijë euro veq një fotografi ka thane me ba, po kesi lule kurr ne jetë tane ski pa”, A. “a eshte atu ai”, B. “po po ski pa ti asi lule”, A. “hade ta kqyrim”, B. “po ata ner 5000-6000 Euro, nuk shitet killa”, A. “te kqyrim çfarë osht”, B. “qe prej qe punoj bari”, A. “rrezikant je”, B. “qe prej qe punojm me bari daj ne qofte se ke pa na krejt edhe ketu ne Kosovë, jon tranu krejt per mu pjek eshte shum te mire”, B. “1900-200, po kan ba killa palidhje, ska kerkush hiq qesi bari”, A. “ edhe nja nje muj ruhen”, B. “3000 euro veq medikamente qe ju kam ble”, A. “a e ke kqyr edhe naj kush”, B. “po more e kom marr edhe teknologun”, A. “e super te thojsha vjet bas që kqyrim se nuk është tu shku mirë”, B. “vjet vet e prisha me plehë”, A. “aha qata ruje”, B. “daj të betohna në krye te femijeve krejt ka njemije e gjashtëqin/njemijë e shtateqind euro, krejt mo mi shit në M., krejt vin M. e marrin, e jepin valla pasha qet rrugë po une vet vëlla per Gj. qesi jau shes”, A. “per natan e dojn qesi te mirë”, B. “po tash ti jau prezanton apo po din qasi te fort, jo nuk ja jepi kurr me 100 gram a din sa i marr une, 1400-1500”.

Nga këto biseda ndërmjet të akuzuari B.I. dhe A.Z., shihet qartë se B.I., ka kultivuar narkotikun dhe e ka shitur këtë narkotik, ku njëri prej personave i cili ka qenë në bashkëpunim për ta shitur narkotikun ka qenë edhe i akuzuari A., ku këta dy të akuzuar në komunikimet e tyre, bisedojnë për shitjen e narkotikut dhe çmimin i cili duhet të ipet në treg sepse është i kualitetit të lartë. Po ashtu këta dy të akuzuar kanë komunikuar ndërmjet vete edhe për çështjen e shitjes së narkotikut jashtë Kosovës dhe atë në Serbi, ku po ashtu theksojnë se edhe farat për mbjelljen e narkotikut janë siguruar nga një person shtetas gjerman, duke theksuar se farat janë siguruar nga “Gjermani”.

Komunikime të cilat e vërtetojnë faktin e shitjes së narkotikut dhe atë para se të kapen një vit, është komunikimi ndërmjet tyre, ku A. i thotë “vjet qka i bane atina a e shite per Serbi”, B. “po krejt ...”. Ndërsa për sigurimin e farave nga personi shtetas gjerman, i akuzuari B.I. në komunikimet e tija thekson se “po Gjermani mi ka ble farat”, e të cilat pastaj janë mbjellë e kultivuar.

I akuzuari B.I., përpos komunikimeve të cilat i ka pasur me të akuzuarin A.Z., rreth kultivimit e shitjes së narkotikut, ai ka komunikuar edhe me të akuzuarin Sh.I., të cilin e ka vëlla dhe shtëpitë e tyre të cilat gjenden në të njëjtin fshat dhe oborr, ku kanë kultivuar narkotikun dhe që të dy kanë bërë shitjen e tij.

Në komunikimet e B.I. me F.M., ku këta dy komunikojnë ndërmjet vete e po ashtu e potencojnë edhe të akuzuarin Sh. I. të cilin e njohin dhe thërrasin me nofkën “C.”, ku B. e njofton F., në fakt e komenton me F. se Sh. e ka një të mirë që e kontrollon narkotikun sa i përket kualitetit dhe atë duke e theksuar se “C.” e bënë këtë punë mirë.

Në bisedën e datës 19.10.2021, B.I. në komunikime me F. M., i theksojnë njëri tjetrit, B. “qka është ka bahet daj, diçka nuk është ka ju pelqen qeky mall”, F. “qikjo është mi lan shume mu pjek”, B. “une qysh e di 1600 i kom pas thanë, ai kom pas than dy killat e para ti jepi ka 1500, C. e ka qeth mirë e duhet me i hi edhe njëherë kapak kontroll ketij malli, ama krejt ka mu shit. Qit te C. t’i rrezon ne tokë, qka ta merr mendja. Kta me gjys kille i nxjerrin qito pare, gjys kille ju jet fal edhe P. është e madhe dikujt i shesin 50 gram, dikujt 100 gram, a neve çka na tha mas dy ditëve vim apet”.

Po ashtu nga këto komunikime shihet se në kultivimin e narkotikut nuk ka marrur pjesë vetëm B., por edhe i akuzuari Sh. dhe se i njëjti ka shitur narkotik dhe atë e vërteton fakti i komunikimit si më lartë “qit te C. t’i rrezon ne tokë”, që kanë theksuar se narkotiku i kultivuar nga “C.”-Sh.I., ka kualitet më të mirë dhe i rrëzon në tokë të gjitha për kualitet e po ashtu se duhet edhe çmimi të paguhet më mirë.

Sh.I., ka marrë pjesë në kultivimin e narkotikut dhe shitjen e tij, e vërtetojnë edhe komunikimet e bëra me datë 25.10.2021, komunikime ndërmjet B.I. dhe Sh.I. i thirrur me nofkën “C.”, ku B. i thotë “bon vaki C., dalin edhe dy a tri killa”, Sh. “krejt a”, B. “po thom, po de”, Sh. “krejt qai ren nuk ka ma a”, B. “jo veq qato qe i murrem ne ate renin e parë ate natë”, Sh. “po jo more qaty si te hin mrena qaty i ki 3 killa qitash po ta garantoj, sa dulen krejt kshtu”, B. “krejt qitash, nja

14 killa jon”, Sh. “po thu”, B. “po de po edhe nje kill eshte prej aty te mirave a pe din o C., a din qato qe i kam nalt”, Sh. “po”, B. “a din qe te thojsha bon vaki 10 killa, prej qatyne jashtë dhe prej ktyne te Serës, po qe me dalin 5 killa a pe din asi te forta, 6 killa dalin me qeta”, Sh. “se citin e ardhshëm kena mi bo kto te fushes ma ne ren se ato te seres”, B. “po ne ser nuk ka pas ksi te mira Cuk”.

Nga këto komunikime të këtyre të akuzuarve, vërtetohet se edhe i akuzuari Sh., ka qenë pjesë e këtij kultivimi të narkotikut dhe shitjes së tij, ku komunikojnë ndërmjet vete si për kualitet, sasi, prodhim në serë e në fushë dhe se cilin kualitet e pranon tregu si kualitet më të mirë.

I akuzuari Sh.I., se ka qenë pjesë e kultivimit të narkotikut dhe shitjes së tij, respektivisht se e ka kryer veprën penale për të cilën është gjetur fajtor, e vërteton edhe komunikimi me të akuzuarin tjetër M.I. të cilin e ka djalë të vëllaut, pra është djali i B.I., ku në komunikimet e tyre të cilat i kanë pasur Sh. me M. me datë 24.10.2021, kanë theksuar, M. “mire e kish, mire krejt hala ish lagt”, Sh. “qfarë miri neper teglla i lagt”, M. “ky ma i mire o me kap e me shit paret ne xhep mi la qato borgje”, Sh. “ka 30 killa a”, M. “ma shumë”, Sh. “qajo e kuqja”, M. “a e kuqja ti ka dy killa”, Sh. “dy”, M. “minimumi 10.000 euro ja merr”. Pra, këto komunikime konfirmojnë faktin dhe veprën penale të kryer nga i akuzuari Sh.I., i cili jo vetëm se ka kultivuar narkotikun por të njëjtin e ka shitur dhe atë përmes M.I. dhe të akuzuarve tjerë në këtë çështje penale.

Jo vetëm këto komunikime të Sh.I. me të akuzuarit e tjerë flasin për faktin e kultivimit e shitjes së narkotikut, por edhe komunikimet e B.I. me F.M. i cili gjendet në arrati, tregojnë dhe vërtetojnë faktin se i akuzuari B.I. dhe Sh.I., kanë kultivuar narkotik dhe të njëjtin e kanë shitur.

Komunikimi i datës 01.11.2021, komunikim i ndodhur ndërmjet B.I. dhe Sh.I., e i cili komunikim vërteton se këta dy të akuzuar, respektivisht i akuzuari Sh. së bashku me të akuzuarin B., kanë kultivuar lëndë narkotike dhe të njëjtat i kanë vënë në shitje, ku në komunikime B. “Merre qata te N.”, Sh. “Hajt hajt”. Ndërsa në komunikimin e mëtejme këta të akuzuar, komunikojnë, Sh. “Hajde”, B. “A po ma bjen nje asi dysh apo kupton”, Sh. “Po a”, B. “Qe shkrun e mire edhe tjetra qe shkrun a din qe o pak ma e mire”, Sh. “Hajt”, B. “Edhe normal nje dyshe”, “Sh. “Dyshe”, B. “E mire edhe normal, dy copa i bjen, nja asi nja ksishne edhe leje qitu”, Sh. “Hajt”, ..., “Hajt, a me kuptove C. qka te thash”.

Të gjitha këto komunikime janë komunikime të ndodhura ndërmjet këtyre të akuzuarve për çështjen e shitjes së narkotikut. Komunikimi duke përdorur nofka për narkotikun, nuk ka të bëjë me asnjë çështje tjetër, por ka të bëjë me narkotikun e kultivuar nga këta dy të akuzuar e i cili narkotik iu është gjetur tek shtëpitë e tyre, si duke e kultivuar e po ashtu edhe përgatitur për shitje. Shitjen e narkotikut të kultivuar, jo vetëm se e kanë shitur vetë personalisht, apo përmes të akuzuarve tjerë të këtij rasti, por ua kanë shitur edhe personave të tjerë të panjohur nga vende të ndryshme në Kosovë, si në P., M. etj., ku në komunikimet e tij i akuzuari B.I., komunikon me të akuzuarin A. se si P. është treg i madh dhe ka vend për ta shitur, e po ashtu edhe nga komunikimet e datës 06.12.2021, me një person të panjohur i cili kërkon që t’i dërgohet narkotiku në M., e ku i akuzuari B. i zotohet se do ia dërgoj për ta furnizuar.

Përpos provave materiale, gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarët e propozuar në këtë çështje dhe atë dëshmitarin G. G. dhe L.N. Këta dëshmitarë në deklaratimet e tyre kanë vërtetuar faktin se të akuzuarit kanë kultivuar narkotik dhe se janë furnizuar nga ta me narkotik.

Dëshmitari G. G. në deklaratimet e tij të bëra gjatë fazës së hetimit, respektivisht ku i njëjti e ka konfirmuar se disa herë është furnizuar me narkotik nga B.I. dhe se është përdorues i narkotikut të lloit “Marihuanë”. Ky dëshmitarë konfirmon se nga viti 2021 e njëh B.I., pasi që merret me prodhimin e dyerve e dritareve dhe se i ka kryer B. një shërbim të ofrimit-montimit të disa dritareve e dyerve dhe se nga ai moment e njëh të njëjtin.

Sa i përket përdorimit të narkotikut dhe furnizimit me narkotik nga B.I., dëshmitari G. G., gjatë hetimeve ka deklaruar se një herë është furnizuar nga B. në shumë prej 50 Euro e dy apo tri herë në shumë nga 10 Euro dhe se këtë narkotik ia ka sjellë i vetëm e po ashtu edhe me të akuzuarin tjetër në arrati F.M.

Ky dëshmitar, në deklaratimet e veta e pranon se ka pasur komunikime me të akuzuarin B. dhe atë duke i kërkuar narkotik si më sill të “jeshilën” e “bac bjerëm diçka”, komunikime të ndodhuara me datë 08.01.2021. Pra, sa i përket këtyre komunikimeve dëshmitari nuk i mohon të njëjtat, por thekson se ka mundësi të ketë komunikuar.

Ky dëshmitar me datë 23.05.2023, ka dëshmuar para gjykatës në shqyrtim gjyqësor, ku ndër të tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi në atë që ka deklaruar në fazën e hetimeve.

Dëshmitari G. G., përpos faktit se gjatë shqyrtimit gjyqësor është munduar ta mohoj se është furnizuar me narkotik nga i akuzuari B.I., por ai pranon se është konsumues i narkotikut dhe atë i “Marihuanës” e të cilën ai e quan “Bari”. Po ashtu ka pohuar se përdor numrin e telefonit ..., e me të cilin numër ka komunikuar me të akuzuarin B.I. për furnizim me narkotik. Faktin e furnizimit me narkotik nga ky i akuzuar, dëshmitari e ka pohuar në deklaratimet e tija gjatë fazës së hetimeve, ku trupi gjykues për ta vërtetuar se deklaratimet të cilat i ka dhënë ky dëshmitarë gjatë fazës së hetimeve a kanë qenë të vullnetshme dhe se a i ka lexuar e nënshkruar vet deklaratimet e tija të dhëna gjatë hetimeve, dëshmitari është përgjigjur se po të njëjtat i ka lexuar e nënshkruar dhe se askush nuk i ka bërë ndonjë presion apo ka shfrytëzuar ndonjë fomë të ndaluar për t’i marrë deklaratimet e tija.

Gjykata, në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar e proceduar edhe dëshmitarin L.N., i cili në deklaratimet e tij ka pohuar faktin se të akuzuarit B.I. e U.Q. i njëh personalisht dhe se U. e njëh nga fëmiriya. Sa i përket përdorimit të narkotikut, deklaroi se është përdorues i narkotikut dhe atë është përdorues i heroinës e kokainës, ku ka pasur shumë raste që së bashku me të akuzuarin U.Q., kanë konsumuar narkotik.

Ky dëshmitar po ashtu në deklaratimet e tij në fazën e hetimit ka theksuar se mjetet financiare me të cilat e kanë siguruar narkotikun, kanë qenë mjete të cilat i kanë mbledhur ai së bashku me U.Q. dhe se ku e ka siguruar U., narkotikun ai nuk e di.

Në pyetjen e parashtruar gjatë fazës së hetimit (deklarimet e tija në polici) dhe atë se çfarë keni biseduar përmes telefonit të U.Q. me B.I., i njëjti ka deklaruar se ka kërkuar që të siguroj narkotik nga B. dhe atë kokainë, mirëpo nuk kanë mundur të sigurojnë pasi që B. nuk ka shkuar tua dërgoj “B. nuk ka dalë”, pra ky është komunikim i datës 20.12.2021.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 12.06.2023, dëshmitari L. N., ka deklaruar pjesërisht sikurse në deklarimet në fazën e hetimit, ku ka pranuar se konsumon narkotik, ka pranuar se së bashku me U.Q., kanë konsumuar narkotik, por se nuk e di se nga U. është furnizuar dhe se që asnjëherë nuk është furnizuar me narkotik nga i akuzuari B.I. Kjo tregon se ky dëshmitar e ka pranuar përdorimin e narkotikut dhe se U.Q. i cili është i bashkëakuzuar me të akuzuarin B.I., ka siguruar narkotikun.

Gjykata në raport me këto deklarime të këtij dëshmitari të bëra në shqyrtim gjyqësor, pjesërisht i ka konsideruar si të vërteta dhe atë të gjitha pohimet e tij sa i përket përdorimit të narkotikut, mirëpo sa i përket faktit se nuk është furnizuar me narkotik nga i akuzuari B.I., gjykata po këtë dëshmitar e ka pyetur se a qëndron pranë deklarimeve të tija të dhëna në fazën e hetimit, i njëjti ka deklaruar se qëndron në tërësi. Po ashtu ky dëshmitar është pyetur nga gjykata se me rastin e dhënies së deklarimeve a është ushtrur forcë, dhunë apo ndonjë formë e ndaluar për t’ia marrë deklaratën dhe se a e ka nënshkruar vetë deklaratën e dhënë në polici me datë 27.05.2022, dëshmitari përgjigjet se deklarata është e vullnetit të tij dhe se vet e ka nënshkruar pa asnjë presion.

Gjykata, vlerësuar deklarimet e këtij dëshmitari të dhëna në fazën e hetimit, po ashtu edhe deklarimet e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, konsideron dhe vërteton se ky dëshmitar pranon si deklarime të veta dhe të dhënë nën vullnetin e tij çdo deklarim të bërë në fazën e hetimit, mirëpo thekson se nuk e di se pse ka deklaruar se ka kërkuar që të furnizohet me narkotik nga B.I. e që ai nuk ka dalur që t’ia ofroj-shes. Nga ky ndryshim i deklarimit në shqyrtim gjyqësor, dëshmitari tenton ta shmang nga përgjegjësia penale të të akuzuarit B.I., mirëpo marrë në konsideratë faktin se i ka pranuar të gjitha deklarimet e tija si të dhëna me vullnet dhe pa asnjë presion, se komunikimi i përgjuar vërteton se ky dëshmitar ka kërkuar narkotik nga B.I., përmes numrit të telefonit të U.Q., gjykata konsideron dhe vërteton se ky dëshmitar është furnizuar me narkotik nga B.I., qoftë vet drejtëpërdrejtë nga ai apo përmes U.Q.

Në shqyrtimin e datës 13.06.2023, i akuzuari B.I., ka dhënë mbrojtjen e tij, ku është deklaruar vetëm në pyetjet e parashtruara nga mbrojtja e tij, por jo edhe në pyetjet e gjykatës dhe të prokurorisë.

Në deklarimet e tija, ky i akuzuar pranon faktin e kultivimit të narkotikut dhe atë vetëm 16 rrënjë t’i ketë mbjellur me qëllim shëndetin e tij, ku në deklarimet e tij ka theksuar “ka një kohë të gjatë që jam i sëmurë dhe kam biseduar me shumë njerëz dhe më kanë thënë që janë të mira mi përdor kundër kancerit”, kjo është arsyeja e vetme dhe se nuk i ka shitur askujt narkotik.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje penale, e sidomos përgjimet e telekomunikimeve dhe dëshmitarët e dëgjuar në këtë çështje, prova të cilat janë elaboruar në



raprot me përgjegjësinë penale-gjendjen faktike, vërtetohet pamëdyshje se i akuzuari B.I., ka kultivuar narkotik të llojit “Marihuanë”, ka shitur e ofruar për shitje këtë lloj të narkotikut e po ashtu edhe kokainë si e dëshmojnë dëshmitë.

Ky i akuzuar në deklaratimet e tij të bëra në fazën e hetimeve, respektivisht në deklaratën e dhënë në polici dhe në prokurori, nuk e mohon faktin e sigurimit të bimëve narkotike për mbjelljen e tyre, mirëpo thekson se këto i ka mbjellur për çështje shëndetësore e jo për qëllim shitjeje, duke pranuar se i gjithë narkotiku si ai i gjetur në gavanoza qelqi e po ashtu edhe ai i mbjellur e duke u tharë, janë për qëllime shëndetësore, por e vërteta e gjetur në këtë çështje penale është gjendja faktike e gjetur sikurse në këtë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në shqyrtimin e datës 13.06.2023, i akuzuari Sh.I., ka dhënë mbrojtjen e tij, ku është deklaruar vetëm në pyetjet e parashtruara nga mbrojtja e tij, por jo edhe në pyetjet e gjykatës dhe të prokurorisë.

I akuzuari Sh.I. në deklaratimet e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se asgjë nuk ka të bëjë me narkotikun e kultivuar dhe shitjen e tij, pasi që jeton i ndarë me të akuzuarin B.I. dhe se në pjesën e shtëpisë ku është gjetur narkotiku duke u terur e tharë, nuk jeton por është dhomë në të cilën ka qasje vetëm i akuzuari B.I.

Gjykata deklaratimet e këtij të akuzuari i konsideron se nuk përkojnë me realitetin dhe gjendjen faktike të vërtetuar me këtë aktgjykim, pasi që nga provat e administruara në këtë çështje penale e sidomos kontrolli i shtëpive, narkotiku i gjetur gjatë kontrollit, komunikimet e bëra ndërmjet të akuzuarve e posaçërisht me të akuzuarin B. e M., i akuzuari Sh., vërtetohet se ka kultivuar narkotik të llojit “Marihuanë” dhe të njëjtin e kanë shitur së bashku me të akuzuarit e tjerë. Po ashtu nuk qëndron fakti se ai në peshoren e gjetur në shtëpinë e tij ka bërë matjen e ushqimeve për prindin e tij i cili vuan nga diabeti, por në të njëjtën peshore janë gjetur mbetje të kokainës si vërtetohet edhe me ekspertizën e narkotikëve, që jep të vërtetohet se ky i akuzuar e po ashtu edhe i akuzuari B.I., janë marrë me kultivim të narkotikut dhe shitjen e tij si të atij që e kanë kultivuar “Marihuanë” e po ashtu edhe të “Kokainës”.

Nga komunikimet e bëra nga Sh.I. me B.I. e M.I., komunikime<sup>7</sup> si:

- B. “qka është ka bahet daj, diçka nuk është ka ju pelqen qeky mall”, F. “qikjo është mi lan shume mu pjek”, B. “une qysh e di 1600 i kom pas thanë, ai kom pas than dy killat e para ti jepi ka 1500, C. e ka qeth mirë e duhet me i hi edhe njëherë kapak kontroll ketij malli, ama krejt ka mu shit. Qit te C. t’i rrezon ne tokë, qka ta merr mendja. Kta me gjys kille i nxjerrin qito pare, gjys kille ju jet fal edhe P. është e madhe dikujt i shesin 50 gram, dikujt 100 gram, a neve çka na tha mas dy ditëve vim apet”; B. “bon vaki C. dalin edhe dy a tri killa”, Sh. “krejt a”, B. “po thom, po de”, Sh. “krejt qai ren nuk ka ma a”, B. “jo veq qato qe i murrem ne ate renin e parë ate

---

<sup>7</sup> Komunikime të bëra ndërmjet të akuzuarve B.I., Sh.I. e M.I. të potencuara në këtë aktgjykim në pjesën e analizimit të provave sa i përket të akuzuarve B.I. dhe Sh.I..

- natë”, Sh. “po jo more qaty si te hin mrena qaty i ki 3 killa qitash po ta garantoj, sa dulen krejt kshtu”, B. “krejt qitash, nja 14 killa jon”, Sh. “po thu”, B. “po de po edhe nje kill eshte prej aty te mirave a pe din o C., a din qato qe i kam nalt”, Sh. “po”, B. “a din qe te thojsha bon vaki 10 killa, prej qatyne jashtë dhe prej ktyne te Serës, po qe me dalin 5 killa a pe din asi te forta, 6 killa dalin me qeta”, Sh. “se citin e ardhshëm kena mi bo kto te fushes ma ne ren se ato te seres”, B. “po ne ser nuk ka pas ksi te mira C.”;
- M. “mire e kish, mire krejt hala ish lagt”, Sh. “qfarë miri neper teglla i lagt”, M. “ky ma i mire o me kap e me shit paret ne xhep mi la qato borgje”, Sh. “ka 30 killa a”, M. “ma shumë”, Sh. “qajo e kuqja”, M. “a e kuqja ti ka dy killa”, Sh. “dy”, M. “minimumi 10.000 euro ja merr”;
  - B. “Merre qata te N.”, Sh. “Hajt hajt”, Sh. “Hajde”, B. “A po ma bjen nje asi dysh apo kupton”, Sh. “Po a”, B. “Qe shkrun e mire edhe tjetra qe shkrun a din qe o pak ma e mire”, Sh. “Hajt”, B. “Edhe normal nje dyshe”, “Sh. “Dyshe”, B. “E mire edhe normal, dy copa i bjen, nja asi nja ksishne edhe leje qitu”, Sh. “Hajt”, ..., “Hajt, a me kuptove C. qka te thash”.

Pra, këto komunikime flasin për kultivim të narkotikut dhe shitje të tij e pjesë e të cilit kultivim dhe shtijeje ka qenë edhe i akuzuari Sh.I., ku po ashtu edhe gjatë kontrollit në pronat e tij është gjetur narkotik duke u kultivuar, tharë e terur dhe i përgatitur për shitje, duke përfshirë edhe mbejtjet e kokainës të gjetura në peshoren e gjetur gjatë kontrollit të pronës së të akuzuarit Sh.I..

Bazuar në provat e administruara e të cilat kanë vërtetuar gjendjen faktike të gjetur me këtë aktgjykim, deklarimeve të këtij të akuzuari (mbrojtjes) të dhëna me datë 13.06.2023 në shqyrtim gjyqësor e po ashtu edhe me datë 24.12.2021, gjatë fazës së hetimeve, nuk i konsideron si të qena, pasi që janë në kundërshtim në tërësi me provat e administruara dhe fajësinë e gjetur mbi këto prova për këtë të akuzuar.

Gjykata, marrë në konsideratë provat e çështjes të cilat janë administruar, ka gjetur se të akuzuarit B.I. e Sh.I:

- Farat për mbjelljen e narkotikut i kanë siguruar nga një person-shtetas Gjerman dhe të njëjtat i ka mbjellur me qëllim shitjeje;
- Sasia e narkotikut e gjetur tek këta të akuzuar, nuk korrespondon me pretendimin e tyre se janë 16 bimë narkotike të mbjelluara, pasi që nga kjo sasi e gjetur gjatë kontrollit, komunikimet e bëra ndërmjet të akuzuarve B.I., Sh.I., F.M. e M.I., flitet për sasi shumë më të mëdha se 16 bimë, flitet për shuma deri në 6000 Euro, çmimi për kilogram e më shumë;
- Sasia e narkotikut është kultivuar për shitje, ku nga komunikimet e bëra shihet qartë se si bisedohet ndërmjet këtyre të akuzuarve për kultivimin e sasisë së narkotikut,

shitjen e tij, se sa është sasia e cila mund të del nga prodhimi, çfarë çmimi mund të shitet në treg (sa mund të jetë përfitimi) dhe se si e sigurojnë tregun e shitjes.

I akuzuari B.I., me këtë aktgjykim është shpallur fajtor edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK. Ky i akuzuar është shpallur fajtor për këtë veprë penale, pasi që gjatë kontrollit të shtëpisë së tij në fshatin ... të Komunës së Gj., është gjetur sasia e municionit të armës, respektivisht 10 fishekë të kalibrit 7.62X54mm me mbishkrimin 19/67 dhe një fishek të kalibrit 7.62X39mm me mbishkrimin 88, municion i armëve i mbajtur paautorizim të organeve kompetente.

I akuzuari B.I., ka mohuar veprën penale, duke konsideruar se mbajtja e këtij municioni nuk është armëmbajtje pa leje sepse është municion e jo armë dhe se i ka mbetur kohë të gjatë në shtëpi ku as nuk e ka ditur që ekzistojnë, mirëpo gjykata bazuar në raportin e kontrollit të shtëpisë së të akzuarit, raport i cili edhe është administruar si provë me rastin e administrimit të provave, është vërtetuar se ky municion është gjetur në shtëpinë e këtij të akzuarit gjatë kontrollit dhe se ky municion po nga ky i akuzuar është sekuestruar fillimisht e më pastaj me këtë aktgjykim edhe është konfiskuar ky municion si armë e mbajtur paautorizim.

Pra, bazuar në faktin e gjetjes në mbajtje paautorizim të këtij municioni (armëve) nga i akuzuari B.I., kontrollit të bërë e hasjes së këtij të akzuarit në mbajtje të këtij municioni, ku gjatë kontrollit të shtëpisë së tij janë gjetur këto municione e sekuestruar, ku gjykata konsideron se në veprimet e këtij të akzuarit, janë përmbushur në tërësi elementet e veprës penale të mbajtjes në kontroll, pronësi e posedim të paautorizuar të armëve.

#### Të akzuarit M.I., U.Q. dhe A.Z.:

Gjykata këta të akzuarit i ka gjetur fajtor për veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Këta të akzuarit kanë shpërndarë e shitur lëndë narkotike dhe atë lëndën narkotike të kultivuar e siguruar nga të akzuarit B.I. dhe Sh.I.. Kultivimi i narkotikut nga të akzuarit e potencuar dhe se këtë kultivim e kanë bërë këta të akzuarit, gjykata vetëm se e ka elaboruar dhe shpjeguar në pjesën e aktgjykimit e cila përshkruan fajësinë e të akzuarve B.I. e Sh.I. Pra, gjykata sa i përket kultivimit e sigurimit të narkotikut e ka elaboruar në këtë aktgjykim, ndërsa sa i përket të akzuarve M.I., U.Q. e A.Z., do e bëjë analizimin e provave në pjesën e mëposhtme të aktgjykimit dhe atë në drejtim të përgjegjësisë së tyre për shpërndarje dhe shitje të narkotikut.

Nga provat e administruara në këtë çështje penale, sidomos nga kontaktet e komunikimet e këtyre të akzuarve ndërmjet vete e po ashtu edhe me të akzuarit B.I. e Sh.I., është vërtetuar përgjegjësia e tyre penale për veprën për të cilën janë shpallur fajtor.

M.I. se ka bërë shpërndarjen e shitjen e narkotikut të kultivuar nga të akuzuarit B. e Sh., tregojnë edhe komunikimet e tij si me Sh.I., ku në komunikimin e datës 24.10.2021, M. “mire e kish, mire krejt hala ish lagt”, Sh.i “qfarë miri neper teglla i lagt”, M. “ky ma mire o me kap me shit paret ne xhep e mi la qato borgje”, Sh. “ka 30 killa a”, M. “ma shumë”, Sh. “qajo e kuqja”, M. “kuqja ti ka dy killa”, Sh. “dy”, M. “te kuqen me ba me shit krejt peseshe ja merr 10000 euro nje kille”, Sh. “po aa”, M. “Minimumi 10000 euro ja merr”.

Nga kjo pjesë e komunikimi shihet qartë se ka të bëjë me komunikim lidhur me narkotikun e kultivuar tek të akuzuarit B. e Sh., ku i akuzuari M.I., njofton të akuzuarin Sh. se narkotiku ende është i lagësht dhe atë ai në gavanoza qelqi, ku ky fakt përputhet saktë me narkotikun e gjetur edhe në vendin e ngjarjes gjatë kontrollit, ku është gjetur narkotik në shtëpitë e të akuzuarve të cilët janë marrë me kultivimin e narkotikut edhe në gavanoza qelqi të bëra gati për shitjen e tyre. Po ashtu ky komunikim i dedikohet edhe çmimit të narkotikut për shitje në treg, ku i akuzuari M. i konfirmon të akuzuarit Sh., se nëse shitet narkotiku “e kuqja” në shuma nga 5 Euro për copë “peshshe”, do të arrij çmimin e shitjes prej 10.000 Euro, që vërteton faktin dhe gjendjen faktike se i akuzuari M.I. është marrë me shitjen e narkotikut dhe atë të atij të kultivuar nga babai i tij e xhaxhai i tij.

I akuzuari M.I., nuk e ka pasur vetëm këtë bisedë apo komunikim lidhur me shitjen e narkotikut, por ka pasur edhe komunikime tjera të njëpasnjëshme, ku me datë 05.11.2021, ky i akuzuar ka pasur komunikim me personin e panjohur (NN), ku ka komunikur për shitjen e narkotikut këtij personi, M. “Allo”, NN “Hej bruda ka je”, M. “Qe ne lokal baba”, NN “A ki mo qasishne more KING”, M. “Vallahi edhe njo e kom nashta”, NN “ni 5-she, a o pesshe qashtu”, M. “Po”, NN “Ani a muj une me ardh me ty kry te hanen se sot vallahi kesh aty e smujta mi nxerr”, M. “Po more bab”, NN “Hajt bruda boma hallall se qe une jom ka vi anena”.

Në komunikimin e datës 12.11.2021, komunikim i ndodhur ndërmejt B.I. dhe M.I., ku ky komunikim i dedikohet shitjes së narkotikut dhe atë B.i “alo”, Mërgimtari “Bak çka bane”, B. “vallahi qe ne Gj.”, M. “po a a mos si 40 euro me veti”, B. “po qetash për pak vij aty te ti”, M. “u kry hajt”, B. “hajt”. Ky komunikim i dedikohet shitjes së narkotikut dhe sasisë në vlerë prej 40 Euro.

Me datë 26.10.2021 e 30.11.2021, i akuzuari M. ka komunikime me personin, apo persona NN, ku në këto komunikime flitet për sigurimin e narkotikut, respektivisht shitjen e tij dhe atë komunikime si NN “hej E. i Babaj jam Babaj Bokes”, M. “fol Babes”, NN “a munesh a muj ma jep nje pesshe deri neser”.

Nga këto komunikime të këtij të akuzuari, gjykata vërteton pamëdyshje gjendjen faktike sikurse në këtë aktgjykim dhe faktin se ky i akuzuar ka bërë shpërndarje e shitje të narkotikut, e cila ka rezultuar me përmbushjen e elementeve të veprës penale për të cilën veprën i akuzuari është shpallur fajtor. Ky i akuzuar në mbrojtjen e tij është mbrojtur në heshtje, mirëpo gjykata fajësinë e tij në raport me veprën penale për të cilën është gjetur fajtor, fajësinë e ka vërtetuar me provat e administruara në këtë çështje penale.

I akuzuari M.I. në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor ka ngelur në heshtje, ku po ashtu në heshtje ka ngelur edhe gjatë deklarimit të tij në polici në fazën e hetimit.

Ky i akuzuar, gjatë dhënies së deklarimeve të tija në Prokurori Speciale, ka mohuar të jetë përdorues i narkotikut e po ashtu edhe se të jetë marrë me shitjen e tij.

Prokuroria Speciale, të njëjtin e ka ballafaquar edhe me komunikimet që ai i ka pasur me të akuzuarin B.I. e të akuzuarin Sh.I., mirëpo i njëjti mohon se këto komunikime të jenë bërë me qëllim të narkotikut, por se këto komunikime kanë të bëjnë me ashtu si i quan ai “Shisha” dhe për shije të saj.

Gjykata, nga komunikimet e këtij të akuzuari që i ka pasur me të akuzuarit e tjerë dhe me personat tjerë, shihet qartë se këto komunikime kanë të bëjnë me narkotik, ku i njëjti komunikon me të akuzuarin Sh., lidhur me terjen e narkotikut, kualitetin e tij dhe se sa do t'i merrte për një kilogram të një lloji të caktuar. Po ashtu komunikime lidhur me narkotikun ka pasur edhe me të akuzuarin B.I. (babain e tij) e po ashtu edhe me personin “NN” të cili i ofron për shitje dhe dakordohen se kur të vijë dhe ku të vijë ta marr narkotikun. Pra, nga arsyetimi i këtij aktgjykimi, sidomos pjesës që ka të bëjë me këtë të akuzuar (M.I.), vërtetohet qartë se kemi të bëjmë me shitje të narkotikut e jo me pretendimet e mbrojtëse të këtij të akuzuari, për këtë arsye gjykata nuk i dha asnjë rëndësi mbrojtjes së këtij të akuzuari në raport me këtë aktgjykim, pasi që nuk përkon me realitetin.

U.Q. e A.Z., se ka bërë shpërndarjen e shitjen e narkotikut të kultivuar nga të akuzuarit B. e Sh., trejgojnë edhe komunikimet e tyre. Këta të akuzuar po ashtu edhe sikurse i akuzuari M.I., kanë bërë shpërndarjen e shitjen e narkotikut të kultivuar e prodhuar nga të akuzuarit B. e Sh.I.

U.Q. në komunikimet e tija, respektivisht në komunikimet me datë 02.11.2021 të bëra ndërmjet B.I. dhe U.Q., ku U. “a është kille a gjys”, B. “jo se kam ketu”, U. “a nime a”, B. “jo vallahi”, U. “se e kam marr barin, ma kan pru barin prej Z. me djeg, me mat sa perqin eshte”, B. “jo sash”, U. “ani ne jse shnosh neser te thirri ne telefon e nihemi si ti marr paret e ti bij”, B. “Daja U. burre edhe ti pe din qe i kum marr veresi”, U. “jo jo e dij sasht problem per ata”, U. “neser athere me ma mat nji fiks nja du me djeg edhe me mat sa perqind po del a njeve”, B. “ani de”. Nga kjo pjesë e bisedës kuptohet se ka të bëjë me lëndë narkotike e ku flitet edhe për ndezjen e saj dhe konsumimin me qëllim të verifikimit të përqindjes së narkotikut dhe kualitetit, ku i akuzuari U. i thotë të akuzuarit B., se “du me djeg edhe me mat sa perqind po del a njeve”.

Gjykata në këtë çështje penale ka proceduar edhe dëshmitarin L.N. dhe atë në seancën gjyqësore të datës 12.06.2023. Ky dëshmitar në deklarinimet e tija ka deklaruar se konsumon narkotik, ka pranuar se së bashku me U.Q., kanë konsumuar narkotik, por se nuk e di se nga U. është furnizuar dhe se që asnjëherë nuk është furnizuar me narkotik nga i akuzuari B.I. Kjo tregon se ky dëshmitar e ka pranuar përdorimin e narkotikut dhe se U.Q. i cili është i bashkëakuzuar me të akuzuarin B.I., ka siguruar narkotikun për të edhe për vete.

Gjykata në raport me këto deklarime të këtij dëshmitari të bëra në shqyrtim gjyqësor, pjesërisht i ka konsideruar si të vërteta dhe atë të gjitha pohimet e tij sa i përket përdorimit të narkotikut dhe faktit të furnizimit nga U.Q., dëshmitari nuk i ka kontestuar. Ky dëshmitarë e ka kontestuar faktin se nuk është furnizuar nga i akuzuari B.I., mirëpo gjykata në pjesën e aktgjykimit sa i përket të akuzuarit B.I., ka elaboruar se mbi bazën e cilave prova ka vërtetuar se i akuzuari U.Q. dhe dëshmitari L.N., si janë furnizuar nga B.I., respektivisht si U.Q. si ka kryer veprën penale për të cilën është gjetur fajtor. Pra, U.Q. e ka kryer veprën penale dhe atë narkotikun e siguruar nga i akuzuari B.I., e më pastaj ia ka vënë në dispozicion L.N., ku ka pasur edhe komunikime lidur me këtë narkotik, e po ashtu është shfrytëzuar edhe telefoni i U.Q. nga personat të cilët janë furnizuar me narkotik dhe këta persona kanë komunikuar edhe me të akuzuarin B.I.

Pra, nga komunikimet e bëra nga i akuzuari U.Q. dhe nga deklaratimet e dëshmitarit, respektivisht provat e administruara në këtë çështje penale, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari U.Q. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari U.Q., në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor i është përgjigjur vetëm pyetjeve të parashtruara nga mbrojtja e tij, ndërsa në pjesën tjetër ka ngelur në heshtje, ku po ashtu në heshtje ka ngelur edhe gjatë deklaratimit të tij në polici në fazën e hetimit.

Ky i akuzuar, gjatë dhënies së deklaratimeve të tija në Prokurori Speciale, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në pyetjet e parashtruara nga mbrojtja e tij, ka mohuar të jetë pjesë e kryerjes së kësaj veprë penale, por nuk e mohon faktin se e njej B.I., Sh.I. e M. I., mirëpo mohon se ka pasur të bëjë ndonjë gjë me këta të akuzuar sa i përket narkotikut.

Prokuroria Speciale, të njëjtin e ka ballafaquar edhe me komunikimet që ai i ka pasur ai me të akuzuarit tjerë dhe me numrin të cilin e ka përdorur, ku ky i akuzuar nuk e ka mohuar numrin e telefonit i cili i është përgjuar, por thekson se nuk e di se për çfarë ka folur, ka folur për një borxh që ia ka pasur B.I. për fasadimin e shtëpisë dhe për disa goma të veturës të cilat goma ia ka siguruar i akuzuari B.I.

Gjykata, këto pretendime mbrojtëse të këtij të akuzuarit nuk i ka konsideruar si të qëna, për faktin se provat e administruara në këtë çështje penale kanë rezultuar me fajësinë e këtoij të akuzuarit, ku ekzistojnë komunikime të këtij të akuzuarit me të akuzuarit e tjerë e po ashtu edhe me persona tjerë si L.N., ku ka siguruar narkotik për shitje e po ashtu edhe ka marrë pjesë në shitje të narkotikut i cili është kultivuar e siguruar nga të akuzuarit B.I. dhe Sh.I.

Gjykata nga komunikimet e këtij të akuzuarit që i ka pasur me të akuzuarit e tjerë dhe me personat tjerë, shihet qartë se këto komunikime, kanë të bëjnë me narkotik, ku i njëjti komunikon me të akuzuarin B., lidhur me kualitetin e narkotikut, ku edhe i pohon se dëshiron ta djegë një nga dozat e narkotikut për të shikuar se çfarë kualiteti është. Po ashtu ky i akuzuar, mohon se t'i ketë shitur e siguruar narkotik dikuj, po nga komunikimet të cilat i ka pasur me dëshmitarin L.N., e po ashtu edhe deklaratimet e këtij dëshmitari të bëra në këtë çështje penale, vërtetojnë se ky i akuzuar ta ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Pra, gjykata nga provat e administruara në këtë çështje penale e të elaboruara sikurse në këtë aktgjykim, ka vërtetuar se ky

i akuzuar është përgjegjës për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se pretendimet mbrojtëse të tij nuk përkojnë me provat e administruara në këtë çështje penale.

A.Z., ky i akuzuar po ashtu është gjetur nga gjykata fajtor për veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paaragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata, me këtë aktgjykim ka vërtetuar se i akuzuari A.Z., në vazhdimësi është furnizuar nga të akuzuarit B. e Sh.I., me narkotik e të cilin narkotik më pas e ka shpërndarë e shitur.

Ndër provat e administruara në këtë çështje penale janë edhe komunikimet e të akuzuarve ndërmjet vehte të siguruara përmes rrugës hetimore. Ku i akuzuari A.Z., ka pasur komunikime të shmuta me të akuzuarin B.I., si për çështjen e kultivimit të narkotikut, cilësisë së narkotikut të kultivuar e po ashtu edhe gjetjes së blerësve në treg për t'ia shitur këtë narkotik të kultivuar nga B.I., Sh.I. dhe i akuzuari në arrati F.M.

Me datë 12.10.2021 dhe atë rreth orës 16:43 minuta, në komunikimet të cilat i kanë pasur të akuzuarit B. dhe A., ku B. “ku je daja G. a ke gjet naj myshteri të mirë a”, A. “jo veq te marrim naj copë te kqyrim, ka disa lloje se afat i ke perzi ti”, B. “daj ka, qe po ta jepi besën e Zotit qe kur nuk ki pas qasi bari hiq asnjëhere”, A. “a i ke nuk ato qe i ki, kos i le si atëherë qe i ke lan se si dihet”, B. “nuk me han hiq, tu betohna se nuk e din kerkush qe i kom veq ty te kom kështu per zemër edhe hiq ski nevoj kerkujna mi thon, thuj ne P. ose P. e kum marr”, A. “jo jo hajt ti, une ju thom prej Shqiperise e kom marr”, B. “ama kurr ne jetën tane ske pas asi bari”.

Nga këto komunikime të akuzuarit A.Z. me të akuzuarin B.I., pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari B., ka kultivuar bimë narkotike dhe se për këto kultivime ka qenë i njoftuar edhe i akuzuari A., i cili ka kontaktuar me persona të tjerë për shitjen e narkotikut, ku e diskutojnë me të akuzuarin B., cilësinë e narkotikut dhe se si personat të cilët i kanë furnizuar me narkotik t'i thonë se narkotiku nuk kultivohet tek këta por është marrë nga dikush tjetër, me qëllim të t'i zhdukin gjurmët me persona të tjerë që të mos e kuptojnë se ku po kultivohet dhe se të besojnë se kualiteti është i mirë, ku i akuzuari B. i thotë të akuzuarit A., thuaj se narkotiku e ke siguruar nga dikush nga P. apo P., ndërsa A. i thot se jo do t'i them se e kam siguruar nga Shqipëria, që të mos kuptohet se ku është siguruar dhe se ka kualitetin e duhur. Këta të akuzuar në komunikimet e tyre, bisedojnë edhe për faktin se si një vit më parë iu ka shkuar puna huq nga mbjellja e narkotikut dhe atë se mos rastësishtë edhe ky vit po ju shkon njejtë, por i akuzuari B. i përgjigjet të akuzuarit A., se sivjet do t'iu shkoj më mire dhe atë kualiteti është shumë i mirë, po ashtu kanë komunikuar edhe për kultivimin e narkotikut në ambiente të pajisura me drita speciale për kultivimin e narkotikut.

Nga këto komunikime gjykata pamëdyshje ka vërtetuar se i akuzuari A., ka pasur njohuri të pakontestueshme se të akuzuarit e tjerë merreshin me kultivim të narkotikut dhe se i njëjti këtë narkotik e ka shpërndarë dhe shitur tek personat tjerë të cilët kanë qenë të interesuar.

Në komunikimet e tyre, i akuzuari A. me të akuzuarin B., kanë biseduar për çmime, ku B. “ka shanca daj njeri pesëmijë euro veq një fotografi ka thane me ba, po kesi lule kurr ne jetë tane ski pa”, A. “a eshte atu ai”, B. “po po ski pa ti asi lule”, A. “hade ta kqyrim”, B. “po ata ner 5000-6000 Euro, nuk shitet killa”, A. “te kqyrim çfarë osht”, B. “qe prej qe punoj bari”, A. “rrezikant je”, B. “qe prej qe punojm me bari daj ne qofte se ke pa na krejt edhe ketu ne Kosovë, jon tranu krejt per mu pjek eshte shum te mire”, B. “1900-200, po kan ba killa palidhje, ska kerkush hiq qesi bari”, A. “edhe nja nje muj ruhen”, B. “3000 euro veq medikamente qe ju kam ble”, A. “a e ke kqyr edhe naj kush”, B. “po more e kom marr edhe teknologun”, A. “e super te thojsha vjet bas që kqyrim se nuk është tu shku mirë”, B. “vjet vet e prisha me plehë”, A. “aha qata ruje”, B. “daj të betohna në krye te femijeve krejt ka njemije e gjashtëqin/njëmijë e shtateqind euro, krejt mo mi shit në M., krejt vin M. e marrin, e jepin valla pasha qet rrugë po une vet vëlla per Gj. qesi jau shes”, A. “per natan e dojn qesi te mirë”, B. “po tash ti jau prezanton apo po din qasi te fort, jo nuk ja jepi kurr me 100 gram a din sa i marr une, 1400-1500”.

Nga këto biseda ndërmjet të akuzuarit A.Z. me të akuzuarin B.I., shihet qartë se B.I., ka kultivuar narkotikun dhe e ka shitur këtë narkotik, ku njëri prej personave i cili ka qenë në bashkëpunim për ta shitur narkotikun ka qenë edhe i akuzuari A., ku këta dy të akuzuar në komunikimet e tyre, bisedojnë për shitjen e narkotikut dhe çmimin i cili duhet të jipet në treg sepse është i kualitetit të lartë. Po ashtu këta dy të akuzuar kanë komunikuar ndërmjet vete edhe për çështjen e shitjes së narkotikut jashtë Kosovës dhe atë në Serbi, ku po ashtu theksojnë se edhe farat për mbjelljen e narkotikut janë siguruar nga një person shtetas gjerman, duke theksuar se farat janë siguruar nga “Gjermani”. Komunikime të cilat e vërtetojnë faktin e shitjes së narkotikut dhe atë para se të kapen një vit, është komunikimi ndërmjet tyre, ku A. “vjet qka i bane atina a e shite per Serbi”, B. “po krejt ...”.

Përpos komunikimeve të cilat kanë qenë ndërmjet të akuzuarit A.Z. me të akuzuarin B.I. e persona të tjerë me të cilët ka biseduar për furnizim e shitje me narkotik, me ekzekutimin e masave të fshehta dhe atë përcjelljes së komunikimeve dhe vendodhjes së tyre, ku vërtetohet se i akuzuari A. ka pasur lëvizje me veturën e tij për tek i akuzuari B.I. dhe atë me qëllim furnizimi e shitjeje të narkotikut dhe të njëjtin narkotik ua ka shitur personave tjerë, respektivisht i ka furnizuar të tjerët me narkotik.

I akuzuari A.Z., në mbrojtjen e tij si në fazën e hetimeve e apo ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka qëndruar në heshtje, mirëpo përpos faktit se i akuzuari ka qëndruar në heshtje me provat e administruara në këtë çështje penale, gjykata të akuzuarin e ka gjetur përgjegjës për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj, gjykata nga provat e administruara në këtë çështje penale, ka gjetur përgjegjës të akuzuarit për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

#### *Fjala përfundimtare e palëve:*

Gjykata, në raport me fjalët përfundimtare të palëve të parashtruara në këtë çështje penale, të njëjtat i ka analizuar dhe elaboruar në pjën e arsytimit të aktgjykimit. Të gjitha pretendimet e



palëve të parashtruara në fjalët përfundimtare, gjykata i ka shtjelluar në arsyetim të aktgjykimi, ku edhe i ka paraqitur qëndrimet e gjykatës në raport me pretendimet e tyre.

#### Vendimi mbi dënimin dhe konfiskimi:

##### *Vendimi mbi dënimin:*

Gjykata gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve, mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese por si rrethana relativisht lehtësuese ndaj të akuzuarve mori: **gjendjen e tyre materiale**, ku gjendja e tyre materiale është nën mesataren familjare, ku të akuzuarit para kryerjes së veprës-veprave penale, ishin të punësuar apo të vetë-punësuar, ku me rastin e arrestimit të tyre është përkeqësuar edhe gjendja materiale e tyre; **të akuzuarit janë mbajtës të vetëm të familjes**, ku përpos që janë mbajtës të vetëm të familjes së tyre, disa prej tyre në përbërjen familjare janë bartës-përkujdesen materialisht edhe për fëmijët e tyre të moshës së re, ku me rastin e arrestimit është përkeqësuar edhe gjendja e përkujdesi material ndaj tyre; **nuk janë të dënuar më herët për veprë penale**, në bazë të të dhënave që posedon gjykata për këta të akuzuar, por edhe të dhënave të ofruara nga organi akuzës, nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kanë rënë ndesh me ligjin më herët, respektivisht nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë, apo të kenë vuajtur ndonjë dënim dhe **sjellja e tyre gjatë gjykimit**, të akuzuarit kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ku sjellja e tyre ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke rrespektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, si rrethana tejet rënduese ka konsideruar:

**Sasia e narkotikut**, në këtë rast të akuzuarit kanë kultivuar sasi të konsiderueshme të narkotikut, e cila sasi fillimisht është kultivuar nga të akuzuarit B. e Sh.I., e më pastaj është shitur e vënë në qarkullim e shitje si nga vet të akuzuarit B. e Sh. I., po ashtu edhe nga të akuzuarit e tjerë, M.I., U.Q. e A. Z. Kjo sasi është kultivuar nga këta të akuzuar e që nënkupton se janë marrë me kultivimin e narkotikut me qëllim shitjeje, ku kjo veprimtari është ndaluar me rastin e arrestimit të tyre e që ky kultivim nga provat e administruara del se ka filluar kohë më parë e jo si pretendojnë të akuzuarit se nuk janë marrë për një kohë të gjatë me këtë kultivim.

**Rrezikshmëria-vlera e mbrojtur shoqërore**, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj veprë penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtyre të akuzuarve), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetrëve, posaqërishtë ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë (shitja e narkotikut bëhet në vende të frekuentuara nga kjo grupmoshë-shitja në restorante e kafiteri si në rastin konkret).

Përpos rrethanave tjetet rënduese të cilat janë theksuar sikurse më lartë, gjykata si rrethana rënduese i ka konsideruar:

**Shkallën e përgjegjesisë penale**, ku varësishtë pjesëmarrjes dhe rolit të të akuzuarve në kryerjen e veprës penale, gjykata për disa nga të akuzuarit bazuar në këtë rrethanë ka shqiptuar dënim më të ashpër në krahasim me të akuzuarit e tjerë, ku të akuzuarve B. e Sh.I., u ka shqiptuar dënimin më të ashpër në krahasim me të akuzuarit tjerë. Këta të akuzuar në raport me të akuzuarit e tjerë kanë qenë më shumë të involvuar në kryerjen e veprës penale të narkotikut, respektivisht në kultivimin, sigurimin e përgatitjen e narkotikut për shitje. Pra, këta të akuzuar janë konsideruar se kanë një rol shumë më të madh se të akuzuarit e tjerë të cilët vetëm se kanë bërë shpërndarjen e shitjen e këtij narkotiku të kultivuar e siguruara nga këta dy të akuzuar (B. e Sh.I.).

**Motivi i kryerjes së veprës penale**, motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi financiar. Të akuzuarit për motive të tyre financiare, respektivisht për përfitim material, kanë anashkaluar të gjitha interesat e përgjithshme shoqërore, kanë anashkaluar jetën, sigurinë dhe shëndetin e përgjithshëm të qytetareve. Kjo nën kupton se të akuzuarit në veprimet e tyre nuk kanë kursyer asgjë në drejtim të kryerjes së veprës penale, respektivisht motivi financiar i tyre i kryerjes së veprës penale ka qenë primar në raport me interesin e përgjithshëm, ku pamëdyshje e kanë ditur se veprimet e tyre janë të kundërligjshme (përbëjnë vepër penale) dhe se narkotiku paraqet rrezik të përgjithshëm shoqëror, mirëpo motivi i tyre i përfitimit material i ka tejkaluar ato.

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarve iu shqiptoi dënimet sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj tyre do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga këto veprime, kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

*Konfiskimi:*

Gjykata me këtë aktgjykim, të akuzuarve iu ka konfiskuar sendet-pasuritë e përdorura, destinuara e të gjeneruara nga dhe për kryerjen veprave penale.

Automjetet dhe pajisjet telefonike të komunikimit të përdorura në kryerjen e veprës-veprave penale:

- Veturë “Mercedes” me targa ..., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari Sh.I., e evidentuar me numrin V#1;
- Veturë “Mercedes” me targa ..., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I., e evidentuar me numrin V#2;
- Vetura “Volkswagen” me targa ..., veturë e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I. e evidentuar me numrin V#3.

Këto automjete janë përdorur nga të akuzuarit B. e Sh. I., në kryerjen e veprës penale, respektivisht në kultivimin, përgatitjen, transportimin e narkotikut për shitje. Ku këto automjete nga këta të akuzuar përmenden në komunikimet e tyre e po ashtu edhe me masat e fshehta teknike të hetimit, është vërtetuar se me këto automjete, këta të akuzuar kanë transportuar e shitur narkotikun të cilin e kanë kultivuar më parë.

- Veturë “Smart” me targa ..., veturë në pronësi (e blerë) nga i akuzuari B.I. dhe e përdorur nga familjarët e tij, e evidentuar me numrin V#4.

Automjeti i lartë-theksuar është automjet i cili është përdorur nga i akuzuari B.I. dhe i akuzuari M.I., ku të akuzuarit kanë pretenduar se ky automjet është pronë e bashkëshortes së të akuzuarit M.I., e të cilin ia kanë blerë prindërit e saj. Gjykata nga provat e administruara, ka vërtetuar se ky automjet është blerë nga i akuzuari B.I. dhe atë me mejetet të cilat i ka përfituar nga kjo veprimtari kriminale dhe se këtë automjet ta kenë përdorur në shpërndarjen e shitjen e narkotikut si nga i akuzuari B. e po ashtu edhe nga i akuzuari M. Pretendimi se ky automjet i përket bashkëshortes së M.I. e të cilin ia kanë blerë prindërit e saj, gjykata e ka vërtetuar të kundërtën, pasi që vet i akuzuari M.I., gjatë deklarimeve të tija në fazën e hetimeve ka potencuar se ky automjet është blerë nga i akuzuari B. I., e jo nga dikush tjetër. Pra, pretendimet e të akuzuarit B.I., nuk përkojnë me realitetin, pasi që ky aset nuk është blerë nga dikush tjetër, është blerë me mejetet financiare të B.I. dhe se është përdorur në kryerjen e veprës penale si nga i akuzuari B. e po ashtu edhe nga i akuzuari M.

- Telefon “Nokia” me IMEI ..., telefon në pronësi të akuzuarit B.I. e evidentuar me numrin T#1;
- Telefon “Iphone” me IMEI ..., në pronësi të të akuzuarit B.I. e evidentuar me numrin T#2;
- Telefon “Iphone” me ngjyrë hiri i modelit A1688(S6) në pronësi të të akuzuarit Sh.I., e evidentuar me numrin F#3;
- Telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë i modelit S9+ në pronësi të të akuzuarit M.I., e evidentuar me numrin F#2;
- Telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë, e evidentuar me numrin F#1.

Pajisjet telefonike të potencuara më lartë e të konfiskuara me këtë aktgjykim, janë pajisje-mjete të cilat janë përdorur në kryerjen e veprës penale, respektivisht janë përdorur në komunikim të cilin e kanë bërë të akuzuarit ndërmjet vete, por edhe me persona të tjerë për shitjen e narkotikut dhe kultivimin e tij për shitje e shpërndarje.

Narkotiku, municioni i armës dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:

Nga i akuzuari B.I., me këtë aktgjykim është konfiskuar sasia e narkotiku, municioni i armës dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:

- Sasia e narkotiku e evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse më lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#7, D#8, D#10, D#10.1, D#13, D#14, D#A.1, D#A.2, D#A.3, D#A.4, D#17, D#18, D#19, D#20, D#20.1, D#22, D#23, D#24, D#25, B#1, B#2, B#3, B#4;
- Mjetet për kryerjen e veprës penale të evidentuara në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#9, D#11, D#12, D#14.1, D#15, D#20.2, D#21;
- Municioni i armës i evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij katgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#16.

Nga i akuzuari Sh.I., me këtë aktgjykim është konfiskuar sasia e narkotiku dhe mjetet e kryerjes së veprës penale:

- Sasia e narkotiku e evidentuar në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij aktgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#1, D#2, D#3 dhe D#5;
- Mjetet për kryerjen e veprës penale të evidentuara në Urdhrin për sekuestrim të përkohshëm nën numrin PP.nr.174/2021 (urdhrin e theksuar sikurse në lartë në dispozitiv këtij aktgjykimi) dhe atë të evidentuara si dëshmi nën shenjën: D#4 dhe D#6.

Sasia e narkotikut e konfiskuar me këtë aktgjykim është sasi e cila është konfiskuar e gjetur me rastin e kontrollit të shtëpive të këtyre dy të akuzuarve, sasi e cila është kultivuar nga këta dy të akuzuar, përgatitur për kultivim e po ashtu përgatitur edhe për shitje. Meqë kjo sasi e narkotikut është material-send i cili është jashtë qarkullimit, gjykata e ka konfiskuar të njëjtën sasi të narkotikut dhe ka urdhëruar që të asgjësohet si material-send jashtë qarkullimit të ligjshëm.

Municioni i armës (fishekët) e konfiskuar me këtë aktgjykim nga i akuzuari B.I., janë konfiskuar pasi që i akuzuari nuk ka poseduar leje-autorizim për mbajtjen e tyre dhe janë sende jashtë qarkullimit të lirë-juridik, derisa nuk posedohet për të njëjtat leje për t'i poseduar në mënyrë të autorizuar.

Po ashtu me këtë aktgjykim janë konfiskuar edhe mjetet me të cilat është kultivuar narkotiku e përpunuar për shitje, ku gjykata këto mjete i ka konsideruar si instrumentalitete të përdorura në kultivimin e narkotikut dhe kryerjen e veprës penale-veprave penale nga të akuzuarit B. e Sh.I.

Andaj, gjykata bazuar në këto fakte e rrethana me këtë aktgjykim i ka konfiskuar sendet-pasuritë e përdoruara, destinuara e të gjeneruara nga dhe për kryerjen veprave penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë në harmoni me nenin 449, 450, 451 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**PS.nr.39/2019 datë 28.07.2023**

**Zyrtar Ligjor,**  
**Fatlum Gashi**

**Kryetari Trupit Gjyqësor,**  
**Valon Kurtaj**

**Bashkëpunëtore Profesionale,**  
**Ardita Azemi**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë.

\*\*\*